BASHKIA LUSHNJE

PLANI SOCIAL VENDOR

BASHKIA LUSHNJE

2022-2025

PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....

1.1 Funksionet e bashkive për sherbimet sociale

2. **Metodologjia.....**

2.1.Politikat sociale vendore të Bashkisë Lusnje

3. Gjëndja aktuale e përfshirjes sociale.....

3.1 Sociograma

4. Shërbimet ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Lushnje.....

4.1 Shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror
4.2 Shërbime ditore dhe komunitare
4.3 Shërbime për integrimin e komuniteti rom dhe egjiptian
4.4 Projekte/iniciativa që po zbatohen apo që do të fillojnë të zbatohen në të ardhmen.
4.5 Prioritetet në zhvillimin e shërbimeve të mbrojtje së fëmijëve në nivel vendor

5. Analiza e aktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve……..

5.1 Situata e mbrojtjes së fëmijëve
5.2 Situata e fëmijëve dhe nevojat e tyre për shërbime të mbrojtjes
5.3 Situata e fëmijëve dhe nevojat e tyre për shërbime të mbrojtjes
5.4 Programi për shërbimin social të Bashkisë Lushnje

6. Varfëria Ekonomike dhe Mbrojtja Sociale.....

6.1 Organizimi i shërbimit të mbrojtjes sociale
6.2 Mbledhja dhe analiza e të dhënave
6.3 Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale
Organizimi i shërbimit të strehimit social

7. Arsimi dhe formimi profesionale.....

7.1 Organizimi i shërbimit të arsimit dhe arsimit profesional

8. Punësimi dhe aftësitë.....

8.1 Organizimi i shërbimit të punësimit dhe aftësisë

9. Pjesëmarrja sociale dhe të drejtat e njeriut.....

9.1 Organizimi i shërbimit për pjesëmarrjen sociale dhe të drejtat e njeriut
9.2 Treguesit socialë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë Lushnje

10. Shëndëtësia.....

10.1 Organizimi i shërbimit të shëndetësisë

11. Drejtoria e Shërbimit Social.....

11.1 Objektivat e Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Lushnje
11.2 Të dhëna mbi organizimin dhe kapacitetet e stafit të Bashkisë

12. Strategjia e zbatimit të planit social.....

13.Plani i veprimit të përfshirjes sociale.....
13.1 Prioritete strategjike për përfshirjen sociale
13.2 Objektivat afatmesme dhe veprimet për përfshirjen sociale
13.3Objektiva afatmesëm arsimit dhe formimit profesional

14.Strategjia e komunikimit të PVPS.....
14.1 Komunikimi institucional gjithëpërfshirës në Bashkinë Lushnje

15.Bibiografia.....

1. Hyrje

Plani Social i Bashkisë Lushnje ka përcaktuar ***objektivat dhe prioritetet strategjike*** tre vjecare **2022-2025** sigurojë dhe ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Ky plan social udhëheq ***zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*** të bashkisë Lushnje duke ndërtuar mbi eksperiencën dhe tëresinë e shërbimeve ekzistuese dhe duke i pasuruar ato me shërbime të reja të domosdoshme për territorin e mbuluar. Ai është dokumenti kryesor që do të orientojë punën për ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe do të bashkërendojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm. Zhvillimi i shërbimeve kryhet në përputhje me kornizën ligjore, të politikave apo strategjive kombëtare, si dhe ato rajonale e vendore.

Plani Social i zonës përfaqëson një ***instrument thelbësor*** nëpërmjet të cilit Bashkia e Lushnjes, në ***bashkëpunim me të gjithë institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat***, harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve dhe të shërbimeve sociale. Ai është një instrument bazë për ***vlerësimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve, realizimin e monitorimin*** e vazhdueshëm të shërbimeve sociale, si dhe për hartimin e politikave lokale sociale dhe planifikimin e projekteve sociale.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal. Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 24 përcaktohet se "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.

Këto funksione dhe përgjegjësi të reja nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendorë, duke shtuar këtu edhe zgjerimin e territorit dhe popullatës që Bashkia duhet të mbulojë me shërbime.
Me tërësinë e veprimtarisë së detajuar në Planin Social Lushnje do të përmbushen nevojat për ***mbrojtje, përkujdesje, rehabilitim, përfshirje sociale dhe riintegrim*** të individëve në përmbushje të përgjegjësive të reja që rrjedhin për bashkitë nga reforma administrive territoriale si dhe ligji i ri për shërbimin e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

E drejta për mbrojtjen shoqërore është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje shoqërore. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen shoqërore .

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale synon një shoqëri në të cilën individët dhe grupet më të cenueshme e të përjashtuar, duke filluar që nga lindja dhe përgjatë moshës së rritur dhe më tej në moshën e tretë, të jenë të mbrojtur dhe në gjendje për të marrë pjesë tërësisht në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë.

1.1 Funksionet e bashkive për sherbimet sociale përfshijnë:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore dhe akreditimin e tyre nga Agjenci Akredituese.
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Qëllimi kryesor dhe përfundimtar i ***reformës administrative territoriale*** është rritja e efikasitetit të administratës vendore, cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve si dhe zhvillimi i drejtë i territorit duke mundësuar burime më të mëdha njerëzore dhe financiare, duke shtuar përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal dhe duke u orientuar drejt një vendimmarrjeje më transparente dhe me më shumë pjesëmarrje. Ndarja e re territoriale shton përgjegjësinë në nivel vendor për zhvillimin e planit social bazuar në vlerësimin e nevojave me pjesëmarrjen edhe të grupeve të interesit për të garantuar një rrjet të qëndrueshëm e cilësor të shërbimeve shoqërore.

Autoritetet e qeverisjes vendore kanë një njohje shumë të thellë të problemeve sociale të komuniteteve të tyre, dhe mbajnë përgjegjësi për menaxhimin dhe administrimin e shërbimeve lokale, kështu që ata mund të luajnë një rol kryesor në drejtimin dhe koordinimin e procesit të planifikimit social. Planifikimi social është një proces që përfshin një hartëzim të nevojave të

populllësisë nëpërmjet mbledhjes dhe vlerësimit të të dhënave me qëllim që të shpërndahen fondet në zonat dhe grupet që kanë nevoja më të mëdha, dhe që kërkon një monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm dhe një përfshirje të aktorëve të ndryshëm.

Në vijim të reformës territoriale të Republikës së Shqipërisë në vitin 2015, Bashkia e Lushnjes kufizohet në veri me bashkitë Rrogozhinë dhe Peqin, në lindje me bashkinë Divjakë, në jug me bashkitë Fier dhe Roskovec, ndërsa në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e bashkisë së re është qyteti i Lushnjes. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.

Sipërfaqja e bashkisë së re është 372.72 km2. Lushnja është zona bujqësore më e rëndësishme e Shqipërisë me prodhime të bimëve të arave, zarzavateve, bostanoreve dhe prodhimeve blegtorale në zonat e ulëta, si dhe me ullinj e vreshta në zonat kodrinore.

Figura 1. Harta Administrative e Bashkisë Lushnje



Burimi: Web page e Bashkise Lushnje

Bashkia Lushnje, sipas INSTAT,Censusit të vitit 2011 numëron një popullsi banuese prej 83.659 vetë, ndërsa në Regjistrin Civil rezulton një popullsi prej 127.438 vetë. Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 244.7 banorë për km^2, ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 341.91 banorë për km^2. Sipas statistikave të fillimit të vitit 2017, pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj bashkie jeton ne zonat rurale, 63 % e saj.

Në kuadër tëLigjit Nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, Bashkia Lushnje, ngarkohet, ashtu si edhe njësitë e tjera të qeverisjes vendore, me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe kompetencash në

fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë ofrimin e shërbimeve shoqërore komunitare, shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me procedurat për marrjen në kujdestari; si edhe menaxhimin e shërbimeve rezidenciale në raste specifike. Gjithashtu, në legjislacion përcaktohen detyrimet specifike për shërbimin shoqëror në nivel vendor, duke përfshirë ngritjen e pikave fokale gjinore dhe të luftës kundër dhunës në familje dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020) cilëson shërbimet e kujdesit shoqëror si funksion i pushtetit vendor, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore. Gjithashtu strategjia shpreh synimin e qeverisë për decentralizimin e plotë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përkundrejt mbështetjes teknike, institucionale dhe financiare nga burimet e buxhetit të shtetit.

Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 vijëzon një orientim të qartë politikash për kujdesin shoqëror, me qëllim reformimin e sistemit, duke theksuar se 'fillimisht identifikojnëçështjet kyçe që duhen adresuar për të ndërtuar një sistem funksional, dhe së dyti përdorim të një qasje me faza për ta zhvilluar këtë sistem'. Në fazën e parë, fokusi vendoset në ndërtimin e themeleve për të lejuar pilotimin e sistemit të ri të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rajone të caktuara. Hapat e hedhur në raport me përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të qarta për bashkitë e formuara rishtazi për planifikimin e shërbimeve tëkujdesit shoqëror (të pasqyruara në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore, strategjinë e decentralizimit dhe atë të mbrojtjes sociale), avancimi i koncepti të paketës bazë të shërbimeve (apo shportës), miratimi i Ligjit 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror,miratimi i Ligjit 18/207 për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës, po përforcojnë bazën ligjore në mënyrë që sistemi të funksionojë duke qartësuar më shumëfunksionimin e sistemit të ri tëkujdesit shoqëror ku ministria përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillon politikat dhe përcakton prioritetet, ndërkohë që Bashkitë janë përgjegjëset kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve tëkujdesit shoqëror.

2. METODOLOGJIA

Për vlerësimin e nevojave në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Lushnje u përdorën teknika të ndryshme të kërkimit, analizës dhe vlerësimit. Në to përfshihen:

1. Hulumtimi i dokumentave strategjike kombëtare dhe legjislacionit kombëtar, pasi politikat lokale duhet të respektojnë legjislacionin dhe standartet kombëtare.
2. Hulumtimi i dokumentave strategjike lokale dhe rregullores së njësisë së qeverisjes vendore.

3. Identifikimi dhe zbatimi i instrumentave të nevojshme për të vlerësuar situatën aktuale në Bashkinë Lushnje në këndvështrimin e individëve dhe grupeve në nevojë për shërbime, si dhe shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë. Të dhënat kryesore të mbledhura përfshijnë:
    a) Të dhëna demografike bazë;
    b) Profili dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit;
    c) Shërbimet egzistuese në territorin e Bashkisë ose që përfshin dhe Bashkinë;
    d) Shpërndarja e shërbimeve në territor;
    e) Financimi i shërbimeve aktuale;
    f) Të dhëna mbi strukturat e ngritura në Bashki dhe njësi administrative në përputhje me ligjin;
    g) Të dhëna krahasuese mbi buxhetin e Bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij;
4. U realizua një intervistë gjysëm e strukturuar me strukturën lokale të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
5. Të dhënat e mbledhura nga grupi lokal, si dhe hulumtimi i strategjive kombëtare e lokale, bashkë më intervistën e zhvilluar mundësuan përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Nevojave.
6. Raporti i vlerësimit të nevojave shërbeu si një bazë e rëndësishme në procesin e përgatitjes së Planit Social të Bashkisë Lushnje dhe bashkë më Planin Social u konsultua gjerësisht me aktorët lokal publik dhe jopublik dhe specifikisht:

    - ✓ Bashkia Lushnje / strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe njësitë administrative;
    - ✓ Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Qarkun e Fier;
    - ✓ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
    - ✓ Ofrues publik dhe jo publik të shërbimeve egzistuese të kujdesit shoqëror në Bashkinë Lushnje;
    - ✓ Organizata joqeveritare që punojnë në territorin e Bashkisë dhe/ose Qarkut me projekte në fushën e kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes sociale;
    - ✓ Përfaqësues nga sistemi arsimor;
    - ✓ Përfaqësues nga sistemi shëndetësor;

Përcaktimi i "planit social të zonës" që ka udhëhëqur përgatitjen e këtij dokumenti:

- Planit Social të Zonës, është një instrument bazë për ***vlerësimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve, realizimin e monitorimin*** e vazhdueshëm të shërbimeve sociale, si dhe për hartimin e politikave lokale sociale dhe planifikimin e projekteve sociale.

- PSZ përfaqëson një ***instrument thelbësor*** nëpërmjet të cilit Bashkia e Lushnjes, në ***bashkëpunim me të gjithë institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat***, harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve dhe të shërbimeve sociale.

Kufizimet:

Në procesin e mbledhjes së të dhënave, saktësia e të cilave përbën bazë të rëndësishme për të identifikuar nevojat për shërbime dhe për vetë përgatitjen e Planit Social, u ndeshën sfida dhe specifikisht:

- ✓ mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë që edhe pse ekzistojnë, nuk rregjistrohen të dhëna për ta.

- ✓ mungesa e qasjes së strukturave egzistuese përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror për ti identifikuar individët në nevojë drejtpërdrejtë në terren dhe jo thjesht kur ata që kanë nevojë për shërbime të drejtohen vetë tek strukturat vendore, gjë që nuk mundëson të dhëna reale mbi individët në nevojë dhe numrin real të tyre.

Konsultimi me aktorë të ndryshëm nxorri në pah faktin që numri i individëve në nevojë në disa grupe vulnerabël është më i lartë se sa shifrat e raportuara. Përmirësimi i mbledhjes së treguesve statistikor është një çështje që adresohet në Planin Social të Bashkisë Lushnje.

2.1 Politikat sociale vendore të Bashkisë Lusnje

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje përmban një sërë objektivash dhe programesh strategjike të cilat ndërlidhen apo drejtojnë zhvillimet në politikat sociale vendore. Një nga objektivat strategjik synon integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, si dhe aksesin në to. Kjo do të realizohet me anë të krijimit dhe specializimit të qëndrave te reja lokale (njësive adminstrative) për rritjen e kohezionit social, si dhe përmirësimin e shërbimeve sociale edhe me programin strategjik për ngritjen e Qëndrave Mulifunksionale dhe shërbimet Sociale.
Do të mbështetet veçanërisht krijimi i shkollave me bazë komunitare si një element integral i përmirësimit të cilësisë së jetesës në zonat informale ku ndihet dhe mungesa e shërbimeve.

Ndikimi i kësaj politike do të jetë si në aspektin e cilësisë së shërbimt ashtu dhe në atë social, ku do të përmirësojë bashkëjetesën komunitare dhe frymën e komunitetit në këto zona.
Ndërkohë objektivi strategjik për cilësinë e lartë të jetës dhe zhvilimin urban do të synojë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe Integrimi e Komuniteteve Rome, Strehimin Social , niveli ekonomik të përballueshëm, si dhe ubanizimin e zonave informale. Integrimi i komunitetit Romë lidhet me përmirësimin e kushteve të jetesës si përmirësimi i banesave, përmirësimi i infrastrukturës së kanalizimeve, futjen e ujit, përmirësimin e kushteve sanitare, ndërkohë që do të shoqërohen me hapjen e hapësirave për integrim social, krijimin e kushteve për punësim, zhvillimin e aktiviteteve të bazuara në komunitetet Romë të cilat përfshijnë edhe qytetarët e tjerë.

Bashkia Lushnje ka zhvilluar ***Politikat Sociale*** për territorin ku vepron të cilat përfshijnë:
Mbulimin sa më të plotë i territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.
Gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimin për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.
Bashkërendimin dhe harmonizimin e aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me instiucionet në varësi të pushtetit qëndror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare. Partneritetin e ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.
Ndërkohë ***kufizimet e këtij plani social*** janë të lidhura me:
a) Mungesën e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për zbatimin të lidhura me ligjin për kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë, si dhe ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.
b) Periudha e decentralizmit të shërbimeve, kompetencave dhe fondeve përkatëse nga niveli qendror në bashki për të cilin nuk ka një proces dhe modalitet të qartë në momentin e përpilimit të planit,
c) Mekanizmi i financimit (fondi social) dhe mekanizmi i përdorimit të fondit (prokurimi i shërbimeve sociale)

3. GJËNDJA AKTUALE E PËRFSHIRJES SOCIALE

Bashkia e Lushnjes, pjesë e Qarkut të Fierit, është e përbërë nga 10 njësi administrative: Allkaj, Bubullimë, Ballagat, Dushk, Golem, Fiershegan, Kolonjë, Krutje, Karbunarë, Hysgjokaj, si dhe pesë rajone me 10 lagje për Lushnjen.


Tabela Nr.1 **Ndryshimet e popullsisë në Bashkinë Lushnje për periudhën 2020-2021**

Gjëndjet Civile	Nr.popullsië Janar 2021	Gusht 2021	Lindjet	Vdekjet	Shërnguljet	Të ardhur
Z.Gj.Civile 1	27627	27613	79	148	740	795
Z.Gj.Civile 2	27418	27376	81	154	638	669
Allkaj	6380	6390	23	32	70	89
Ballagat	3903	3937	13	15	30	66
Bubullimë	7189	7194	42	41	65	69
Dushk	12413	12471	34	47	130	201
Fiershegan	9895	9953	35	29	87	139
Golem	7822	7867	27	29	114	161
Hysgjokaj	3679	3711	12	10	25	55
Karbunarë	5712	5710	13	21	65	71
Kolonjë	8370	8369	49	49	91	90
Krutje	10314	10341	43	43	96	123

Burimi: Zyra e Gjëndja Civilet Lushnje


Sipas të dhënave nga Gjëndaj Civile Lushnje , në harkun kohor Dhjetor 2020 – Gusht 2021 shtesa natyrore e popullsisë duke përfshirë dhe njësitë administrative të bashkisë, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku Nr.1 **Ndryshimet e popullsisë në Bashkinë Lushnje për muajt Janar-Gusht 2021**



Burimi: Zyra e Gjëndja Civilet Lushnje


Grafiku Nr.2 Raporti i shtimeve dhe pakësimeve të popullsisë në Bashkinë Lushnje për muajt Janar-Gusht 2021



Burimi: Zyra e Gjëndja Civilet Lushnje

Grafiku i paraqitur nr.2 në planin social 2021-2023 përkthehet në termin *shtesa* që do të thotë në numërin e linjeve për atë periudhë , gjithashtu edhe lëvisjet e popullsisë të ardhur në Bashkinë Lushnje. Ndërsa për termin *pakësim* është përdorur për kuptimin e fjalës në munërin e vdekshmërisë dhe shpërnguljet e popullsisë nga Bashkia Lushnje.

Grafiku 3. Shtesa natyrore e popullsisë në Bashkinë Lushnje 2020-2021[1]



Burimi: Zyra e Gjëndja Civilet Lushnje

[1] Të dhënat janë marr nga Gjëndja Civile Lushnje, në kuadër dhe të ligjit *nr. 115/2015 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" 31.07.2015*

Bashkia Lushnje në bashkëpunim me Zyrat e Gjëndjes Civile Lushnje ka hartuar tabelën nr.1 mbi shtesat natyrore e përcaktruar në % të popullsisë së bashkisë konkretisht Bashkia Lushnje në vitin 2020 kishte 130722 banorë ndërsa për vitin 2021 është rritur numëri i popullsisë Lushnje me 210 banorë .

3.1 Sociograma

Në përfshirjen sociale në bashkinë Lushnje kanë rol një tërësi aktorësh, institucionalë, të të gjithë niveleve të qeverisjes, dhe jo institucionalë, të cilët mbulojnë drejtpërdrejtë këtë fushë, ose objekti i të cilëve ndërlidhet me elementë të saj; këta aktorë paraqiten në një sociogramë, të grupuar sipas gjashtë fushave të politikave mbi përfshirjen sociale

Bashkia Lushnje është institucioni *vendor* përgjegjës për dhënien e shërbimeve sociale për banorët në territorin nën administrimin e saj; në kuadër të këtij funksioni ligjor,ajo harton dhe zbaton Planin Vendor të Veprimit për Përfshirjen Sociale.

Ministria e Shëndëtesisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni *qëndror* drejtpërdrejt përgjegjës për përfshirjen sociale në nivel kombëtar, hartues dhe zbatues i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2019-2024. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomise dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë institucione qëndrore puna e të cilëve ndërthuret me përfshirjen sociale, e për rrjedhojë, janë aktorë kryesor në disa fusha të saj, përkatësisht arsim, formim profesional, shëndetësi e strehim.

Drejtoritë *rajonale* të këtyre ministrive, të vendosura në qarkun e Fierit, pjesë e të cilës është qyteti i Lushnjes janë aktorë përfaqësues të niveli i dytë qeverisës në sociogramë. Në vazhdim paraqitet sociograma në formë skematikePër çështje të pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut janë aktor të rëndësishëm institucioni i Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut.

Shoqëria civile është gjithashtu aktive në çështjet e përfshirjes sociale që prekin bashkinë Lushnje përmes organizatave joqeveritare të cilat zbatojnë projekte të shërbimeve sociale që mbështeten me fonde dhe koordinohen nga Bashkia ose donatorë vendas apo të huaj. Aktualisht, në bashkinë Lushnje veprojnë një sër organizatash të shoqërisë civile dhe pjesa e tyre që kanë rol më të madh në çështjet e përfshirjes sociale veprojnë ngushtë me Bashkinë; nisur nga objekti i secilës prej tyre, shoqëra civile në këtë bashki vepron më shumë në fushën mbrojtjes sociale, punësimit dhe zhvillimin e aftësive të punëkërkuesve, e gjithashtu në çështje të pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut.

4. SHËRBIMET EKZISTUESE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË BASHKINË LUSHNJE

Në territorin e Bashkisë Lushnje situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve paraqitet si më poshtë:

4.1 Shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror

Deri më tani, Bashkia e Lushnjes nuk ka mundur ende të ngrerë apo mbështetë shërbime të një natyre rezidenciale, për asnjë nga kategoritë apo grupet në nevojë, si të moshuarit, fëmijët, gratë e dhunuara etj. Kjo është një mangësi mjaft e ndjeshme dhe ngritja e një qendre rezidenciale është nënvijëzuar shpesh si një prioritet gjatë procesit të vlerësimit që i parapriu hartimit të këtij plani. Kur flasim per femijet, ne kete bashki ngritja e nje sherbimi rezidencial per ta vleresohet si e rendesishme sidomos per femijet me aftesi ndryshe.

4.2 Shërbime ditore dhe komunitare

- *Aktiviteti NjMF-së pranë Bashkisë.*

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, e ngritur në prill të vitit 2011 me mbeshtetjen e shoqates Refleksione, zbaton procedura në raport me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve specifike të fëmijëve në nevojë për t'u marrë në mbrojtje, ashtu edhe përsa i takon roleve të tjera si atyre ndërgjegjësuese, koordinuese etj. Kjo strukture gjithashtu drejton grupin multidisiplinar për ndjekjen e rasteve.

- *Qendra komunitare për fëmijë me AK*

Qëndra e zhvillimit të femijëve me aftësi të kufizuara ndodhet në territorin e bashkisë Lushnje, pranë spitalit "Isan Cabej ". Qendra është financuar nga PNUD-i dhe trajton me terapi fëmijë të moshave të ndryshme nga 6 - 18 vjec. Kapaciteti i qëndrës është për 24 femijë ndërkohë që aktualisht marrin shërbime 54 fëmijë. Qendra është ditore dhe ofron dhe dy shtretër për rastet, kur prindërit e fëmijëve kanë nevoja emergjente për t'i lënë fëmijët, por jo më shumë se dy netë.

- *Qëndra "Shërbëtoret e vogla të zemrës së krishtit" Plug*

Ajo është qendër ditore jopublike e cila ka kapacitet maksimal prej 60 personash dhe aktualisht ofron shërbim për 35 fëmijë. Kjo qender ka sherbyer edhe si qender emergjence duke ofruar sherbimet e saj dhe per rastet e dhunës në familje.

4.3 Shërbime për integrimin e komuniteti rom dhe egjiptian

Në vitin 2013 Bashkia Lushnje ka miratuar Planin e veprimit per integrimin e komuniteti rom dhe egjiptian 2013-2015. Ky plan u realizua në kuadër të projektit "Praktikat më të mira për integrimin e Romëve". Ai synonte të adresonte problematikat e hasura nga këto komunitete në fushën e arsimit, punësimit, mbrojtes sociale, stehimit, infrastrukturës, përfshirjes sociale, shëndetit dhe integrimit social. Nuk ka një raport vlerësimi përsa i përket impaktit të këtij plani në përmbushjen e objektivave strategjikë të vendosur.

4.4 Projekte/iniciativa që po zbatohen apo që do të fillojnë të zbatohen në të ardhmen.

Bashkia Lushnje nuk ka ende plane konkrete për projekte në raport me shërbimet shoqërore me fokus fëmijët. Megjithatë, në prioritetet e saj janë ristrukturime dhe pasurime të strukturave ekzistuese. Synohet rritja e numrit të punonjësve në bashki që do të kenë si fokus dhe mbrojtjen e fëmijëve.

4.5 Prioritetet në zhvillimin e shërbimeve të mbrojtje së fëmijëve në nivel vendor

Bazuar në një analizë dhe vlerësim të situatës së deritanishme si dhe në nevojat për shërbime në territorin e Bashkisë Lushnje, nga intervistat dhe diskutimet me stafin e saj dhe partnerët, janë identifikuar prioritetet e mëposhtme për zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve për t'i reflektuar në planin e veprimit 2019-2022.

Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:

- Zhvillimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve;
- Shtimi në organikë i profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve sipas parashiimeve që bën ligji për mbrojtjne e të drejtave të fëmijëve (Nr i Banorëve – 118 397 (minimumi duhet të jenë 11 punonjës socialë; 2014- **29'167** fëmijë - minimumi duhet të jenë 9 PMF)
- Mbulimi më i mirë në terren për rastet që trajtohen, përfshirë vizitat në shtëpi.
- Riorganizimi dhe pasurimi i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.
- Përforcimi i praktikave dhe kulturës së punës për regjistrimin e rasteve të trajtuara për krijimin e databazave.

Zhvillimi i shërbimeve të reja:

- Ngritja e një qendre rinore për të zhvilluar interesat sociale, kulturore dhe sportive për fëmijët dhe të rinjtë e Bashkisë Lushnje.
- Ngritja e një qendre ditore dhe strehëze me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe strehimin e përkohshëm të rasteve në situatë emergjence: viktima të dhunës në familje, fëmijëve të familjeve të varfëra, etj.
- Ngritja e shërbimeve për trajtimin e problematikave të abuzimin me substanca/varësisë nga droga për fëmijë dhe të rinj.
- Ngritja e strukturës së njësisë së vlerësimit dhe referimit pranë bashkisë;
- Ndërtimi i mjediseve miqësore për fëmijët pranë strukturave që ligji parashikon për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF, komisariate, shkolla, qendra shëndetësore, etj.)

5. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

5.1 Situata e mbrojtjes së fëmijëve

Të gjithë partnerët pohojnë se shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve të ofruara deri më tani kanë qenë të pakta, me shtrirje dhe kapacitet shumë të limituar për t'iu përgjigjur diversitetit dhe thellësisë së nevojave të fëmijëve duke mbuluar vetëm një pjesë të nevojave më bazë dhe elementare të tyre. Ekziston nevoja për shërbime më të plota dhe të integruara, sidomos për problematikat dhe target grupet e mëposhtme:

- ***Fëmijët dhe varfëria/papunësia***

Rreth 100,000 fëmijë në të gjithë Shqipërinë janë të rrezikuar çdo ditë nga uria dhe varfëria, ndërkohë që 20% e tyre jetojnë në varfëri absolute. Kjo problematikë, e nënvijëzuar nga të dhënat e raporteve si dhe nga të dhënat parësore, adresohet kryesisht, përmes skemës së ndihmës ekonomike. Megjithatë, statistikat në vite në raport me familjet në nevojë, ato aplikuese dhe ato përfituese nuk janë të plota për të vlerësuar mbi shkallën e mbulimit të nevojave. Në përgjithësi, totali i ndërhyrjeve (qëndrore apo lokale) për adresimin e varfërisë ekstreme duket se është ende i pamjaftueshëm dhe problematika persiston e thellë, veçanërisht në zonat rurale.
Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje të papuna në vitin 2011 në Lushnje 4.64 (Ceni, 2011). Ndërkohë që nga i njejti burim percaktohet se numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që marrin përfitime është 33.29.

- ***Aftësia e Kufizuar***

Në raport me fëmijët me AK, bashkia ofron shërbime për ta nëpëmjet një qendre të ngritur në bashkëpunim me PNUD. Në total Bashkia raporton 600 fëmijë me AK, sipas tabelave të mëposhtme:

EMERTIMI	NUMRI I FEMIJEVE ME AK GJITHSEJ							NGA GJITHSEJ SA JANE FEMRA							SISTEMI ARSIMOR QE NDJEKIN			
	SIPAS GRUP-MOSHAVE							SIPAS GRUP-MOSHAVE										
	GJithsej	0-6 vjeç	Rom	6-15 vjeç	Rom	15-18 vjec	Rom	Gjithsej	0-6 vjeç	Rom	6-15 vjeç	Rom	15-18 vjec	ROM	GJithsej	Para-shkollor	9-vjeçar	I mesem
PREFEKTURA																		
BASHKITE																		
BASHKIA LUSHNJE	600	88	0	318	1	194	0	372	47	0	225	0	100	0	530	64	293	173
	0							0							0			
	0							0							0			
	0							0							0			
	0							0							0			
Totali	600	88	0	318	1	194	0	372	47	0	225	0	100	0	530	64	293	173

Nr.	EMERTIMI	NUMRI I FEMIJEVE ME AK GJITHSEJ							NGA GJITHSEJ SA JANE FEMRA							SISTEMI ARSIMOR QE NDJEKIN			
		SIPAS GRUP-MOSHAVE							SIPAS GRUP-MOSHAVE										
		GJithsej	0-6 vjeç	Rom	6-15 vjeç	Rom	15-18 vjec	Rom	Gjithsej	0-6 vjeç	Rom	6-15 vjeç	Rom	15-18 vjec	ROM	GJithsej	Para-shkollor	9-vjeçar	I mesem
	PREFEKTURA																		
	BASHKITE																		
1	BASHKIA LUSHNJE	406	41	0	215	0	150	0	302	29	0	187	0	86	0	393	35	210	148
2	Hyzgjokaj	16	1	0	11	0	4	0	3	1	0	2	0	0	0	13	0	9	4
3	Allkaj	14	2	0	9	0	3	0	3	0	0	2	0	1	0	11	5	2	4
4	Ballagat	12	2	0	5	0	5	0	3	1	0	1	0	1	0	5	0	4	1
5	Bubullime	10	3	0	6	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0	10	2	7	1
6	Dushk	25	6	0	19	1	0	0	10	1	0	7	0	2	0	25	6	19	0
7	Fier-Shegan	31	9	0	17	0	5	0	21	5	0	14	0	2	0	30	9	18	3
8	Krutje	29	12	0	12	0	5	0	9	3	0	3	0	3	0	19	2	12	5
9	Kolonje	25	2	0	12	0	11	0	11	1	0	7	0	3	0	13	2	7	4
10	Karbunarë	9	4	0	1	0	4	0	1	1	0	0	0	0	0	3	2	1	0
11	Golem	23	6	0	11	0	6	0	8	4	0	2	0	2	0	8	1	4	3
	TOTALI	600	88	0	318	1	194	0	372	47	0	225	0	100	0	530	64	293	173

Burimi: Bashkia Lushnje, shtator-tetor 2019

Ndër nevojat më emergjente për të adresuar nevojat e këtij grupi janë:

- Nevoja për përmirësim infrastrukturor të mjedisit;
- Nevoja për shtim të stafit, veçanërisht atij të specializuar sipas nevojave specifike të rasteve që trajtohen në qendrën e bashkisë;
- Sigurimi i shërbimit në shtëpi për fëmijët me AK që jetojnë në zona rurale të thella (sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligjit dalë për shërbime në shtëpi për shtresat vulnerable, dhjetor 2016)

- ***Fëmijët dhe dhuna***

Dhuna ndaj fëmijëv u pranua si dicka që ndodh në komunitetin e Lushnjes. Shpesh herë dhe i justifikuar nga mitet që e shoqërojnë ekzistencën e saj. Pasojat abuzimit të fëmijëve mund të jenë shumë komplekse, afatshkurtra dhe afatgjata. Kjo sjell nevojën e ofrimit të një mbështetjeje dhe asistence me shërbime të kombinuara, multidisiplinare dhe të përshtatura me nevojat specifike të çdo rasti të identifikuar. Kështu, një nevojë e menjëhershme për adresim, është prioritizimi i kësaj

çështjeje dhe dedikimi i burimeve njerëzore dhe financiare për trajtimin e saj. Nga ana tjetër ngritja e një qendre emergjencash është një domosdoshmëri si për rastet e fëmijëve që kërkojnë mbrojtje ashtu edhe për gratë e kërcënuara nga dhuna në familje. Kjo bashki nuk ka një linjë këshillimi 24 ore. Gjithashtu, mekanizmi i identifikimit dhe raprotimit të tyre nuk funksionon.

- ***Fëmijët e familjeve të kthyera nga emigrimi/azili***

Një kategori fëmijësh në rritje, me problematika sociale, janë ata që familjet e tyre kanë emigruar dhe janë rikthyer nga emigrimi afatgjatë apo nga procesi i azil kërkimit në vende të BE-së. Një pjese e tyre, në momentin e rikthimit kanë nevoja emergjente që nga ushqyerja deri tek strehimi. Deri tani nuk ka ndonjë nismë/masë specifike për ta. Aktorë të ndryshëm të intervistuar për qëllimet e këtij vlerësimi theksuan nevojën për të ngritur një qendër pritëse për emigrantët/azilkërkuesit e kthyer.

5.2 Situata e fëmijëve dhe nevojat e tyre për shërbime të mbrojtjes

Fëmijët e përfshirë në këtë vlerësim, të pyetur lidhur me problematikat me të cilat ata ballafaqohen si dhe me rolin e Bashkisë në adresimin e tyre, rendisin një sërë çështjesh ku do dëshironin të kishin më shumë nga Bashkia në tërësi dhe NjMF-ja në vecanti.

- Njohje sa më të mirë të rolit dhe shërbimeve që ata mund të marrin nga NJMF-ja. NJMF-ja në punën e saj ka të parashikuar takime periodike me nxënësit e shkollave 9-vjecare dhe gjimnazeve. Megjithatë, një pjesë e fëmijëve nuk e njihnin si strukturë dhe shumë pak dinin mbi shërbimet që ajo ofron.
- Dhuna përkundrejt fëmijëve perceptohet si dicka krejt normale, që ndodh në familje he në instiutcionet arsimore. Fëmijët pohojnë se në raste të tilla nuk kanë ku ta adresojnë problemin e tyre sepse mungon konfidencialiteti dhe për ta kjo është një faktor që i bën të mos e raportojnë atë. Bullizmi gjithashtu është një fenomen i përhapur, sidomos te fëmijët e gjimnazeve.
- *Shërbimi psiko-social në shkolla*: ky shërbim është i konsoliduar në këtë bashki. Fëmijët e klasave të 8-9 dhe ata të shkollës së mesme nënvijëzuan domosdoshmërinë e këtij shërbimi kundrejt problematikave në rritje përsa i takon bullizmit në shkollë dhe rritjes së problematikës së përdorimit të substancave narkotike. Megjithatë, ky shërbim është i pamjaftueshëm duke konsideruar numrin shumë të madh të nxënësve që një punonjës social/psikolog duhet të mbulojë (2200 nxënës).
- *Shkolla si qendër komunitare*: edhe pse shndërrimi shkollës në një qendër për të gjithë komunitetin është vendosur si prioritet kombëtar në fushën e arsimit, vetë fëmijët nuk e ndjejnë këtë rol të pritshëm të saj as në vija të përgjithshme e as në raport direkt me ta.

Përvec mësimdhënies, fëmijët ndjejnë se nuk marrin asnjë shërbim apo mbështetje tjetër nga shkolla.

- *Jeta kulturore dhe sportive për fëmijët dhe të rinjtë*: mundësitë për pasurimin e jetës kulturore dhe sportive të fëmijëve dhe të rinjve nuk duhet të shihen vetëm të lidhura me shkollën. Deri tani ata raportojnë se kanë nevojë ta ndjejne më shumë rolin e Bashkisë në jetët e tyre. Pritshmëritë e tyre janë modeste, në përputhje edhe me mundësitë që Bashkia mund të ketë, Në qytetin e Lushnjes ka një qender kulturore për fëmijë, por që fëmijët e identifikonin vetëm për festa, kur kjo qendër organizonte aktivitete kulturore. Gjithashtu duhet shtuar se gjelbërimi në qytet është rritur me ritme të shpejta por vetëm në qendër të qytetit, shumica e lagjeve mbeten problematike, qytetaret e lagjeve të brendshme ankohen se nuk e kanë këtë shërbim atje ku jetojnë, veçanërisht, theksojnë mungesën e hapësirave të gjelbra e çlodhëse për fëmijë, gra dhe moshën e tretë.
- *Shërbime për mbështetjen e të rinjve përdorues të substancave narkotike*: problematikat e fëmijëve dhe të rinjve me substancat narkotike u identifikuan nga vetë ata, por edhe nga ekspertë si p.sh nga të intevisuarit në sektorin psiko-social të shkollave. Kjo problematikë është kthyer në një emergjencë si për fëmijët të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë, për prindërit e tyre që janë të papërgatitur për t'i bërë ballë, për mësuesit dhe shkollën që gjithashtu më shumë e ka injoruar sesa adresuar çështjen, ashtu edhe për komunitetin në tërësi pasi fëmijët apo të rinjtë përdorues të këtyre substancave përfshihen jo rrallë herë edhe aktivitete antiligjore.

5.3 Partneriteti me OJF-të

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishën në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve. Megjithatë, Bashkia Lushnje e ka mjaft të kufizuar edhe këtë aset duke marrë në konsideratë numrin e ulët të OJFve të vendosura në këtë bashki.

Është një fakt mjaft pozitiv që këto OJF janë të gjitha tëpërfshira në bashkëpunime dhe janë të mbështetura në misionin e tyre nga Bashkia Lushnje. Ato raportojnë për raporte të mira bashkëpunimi, megjithatë presim më shumë mbeshtetje në terma konkretë.

Bashkia Lushnje duhet të ndërtojë sisteme dhe mekanizma referimi të cilat të përfshijnë edhe OJF-të lokale si aktorë shumë të rëndësishëm. OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund tëveprojnë edhe më shpejt se institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve. Nga ana tjetër, organizatat janë gjithmonë në kërkim të fondeve dhe burimeve dhe në varësi të disponueshmërisë së tyre, ato nuk janë gjithmonë aktive. Në lidhje me punën e organizatave deri tani nuk është hartuar ndonjë

marrëveshje formale apo ndonjë plan bashkëpunimi, pa përcaktuar kështu ndonjë përgjegjësi. Është e nevojshme ekzistenca e një vullneti të fortë nga vendimmarrësit për të zhvendosur këtë qasje të rëndësishme së bashku me ndryshimet në ligjin e prokurimit publik.

5.4 Programi për shërbimin social të Bashkisë Lushnje


Programi për Shërbimin Social parashikon mbrojtjen sociale për grupet në nevojë të ofruar me anë të (i) pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuar. Kjo pjesë e programit realizohet plotësisht me fonde qëndrore; nga ana tjetër, Bashkia planifikon çdo vit një fond për grupet në nevojë që, për arsye të caktuara, nuk përfitojnë nga skema qëndrore e ndihmës ekonomike, por të cilat Bashkia e gjykon të nevojshme t'i mbështesë financiarisht jashtë kësaj skeme; për vitin 2021 fondi që Bashkia Lushnje ka miratuar nga buxheti i saj për kujdesin social është 34,626.440 lekë.

Pjesë e Programit për Shërbimin Social parashikohet strehimin social me një fond i cili përbëhet nga shpenzime operative të planifikuara gjithësej 4,000.00 lekë
Shpenzime të parashikuara për qera ambienti për moshën e tretë është një fond prej 1,920.00 lekë ndërsa për transortin urban që përfitojnë personat me aftësi të kufizuar është pareashikuar fondi prej 1,600.00 lekë.

Në fondit e përgjithshëm të deklaruar paga e dy personave që në strukturë të bashkisë Lushnje janë punonjës menaxhim rasti dhe shërbime shoqërore, plus sigurimet e tyre me fondë gjithësej 1,540.44 lekë.

Qëndra PAK , është një 0071ëndër ditore e cila ofron shërbimin për fëmijët me aftësi të kufizuar të grupmoshave të ndryshme duke variuar nga 2 deri në 16 vjeç dhe funsionon në pesë ditë të javës nga e hëna në të premte. Funksioni i të cilës është e parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lushnje me një fond gjithësej 14,366.00 lekë.
Me fondin 11,200.00 lekë pjesë e fondit të kujdesit social është e përfshirë për komisionet PAK dhe fondi 6% që kalon për familjet në nevojë.

Grafiku: Shpenzime operative, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Lushnje



6.VARFËRIA EKONOMIKE DHE MBROJTJA SOCIALE

Strategjia Kombëtare e Mbrojtes Sociale 2019-2023 dhe Plani i Veprimit në Zbatim të saj, përcakton objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në këto synime:

- Zhdukja e varfërisë kudo dhe në të gjitha format.
- Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.
- Sigurimi i arsimimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të gjithë.
- Arritje e barazisë gjinore dhe fuqizim i grave.
- Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë.
- Qytete për të gjithë, të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme.

6.1 Organizimi i shërbimit të mbrojtjes sociale

Varfëria ekonomike dhe mbrojtja sociale kanë qenë dhe janë prioritet për Bashkinë e Lushnjes në hartimin e politikave të saj për shërbimin social. Siç paraqitet në organigramën e Drejtorisë së Shërbimit Social në paragrafin e mësipërm, sektorët që mbulojnë këtë fushë janë:

1. Sektori i Pagesave CASH
2. Sektori i Përkujdesit Social

Sektori i Pagesave CASH përbëhet nga 15 administratorë shoqërorë dhe 1 specialist për grupin e personave me aftësi të kufizuar; nga administratorët, 5 janë përgjegjës për qytetin e Lushnjes, i cili ndahet në 5 rajone, dhe 10 janë përgjegjës për njësitë administrative Allkaj, Bubullimë, Ballagat, Dushk, Fiershegan, Golem, Kolonjë, Hysgjokaj, Krutje dhe Karbunarë.

Sektori i Përkujdesit social ka në varësi Qëndrën e Zhvillimit Lushnje (qëndrën PAK) të shërbimit në komunitet (ditor),

Qëndra e Zhvillimit Lushnje (Qëndra P.A.K), e vendosur në qytetin e Lushnjes, është ngritur në vitin 2015 dhe trajtohen fëmij të moshës 3-16 vjeç. .Aty aktualisht trajtohen 60 fëmijë me aftësi të kufizuara. Ajo përbëhët nga 18 punonjës, 1 përgjegjës, 1 mësues social, 2 logopedistë, 5 psikologë, 2 fizioterapistë dhe nga stafi i nevojshëm për mirëmbajtjen e saj (kuzhinier, pastrues, ndihmës etj.). Fëmijët në qëndër marrin shërbim në 3 turne, ku turni i paradites janë fëmijët që nuk frekuentojnë shkolla apo kopshte, turni i dytë janë fëmijët që frekuentojnë shkolla/kopshte me orar të reduktuar ndërsa turni i pasdites janë fëmijë që frekuentojnë rregullishtë shkollat dhe kopshtet. Duke qënë se një ndër qëllimet e saj qëndre është të integrojnë fëmijët me aftësi të kufizuar në shoqëri.

6.2 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Në Bashkinë Lushnje, grupi i individëve dhe familjeve në nevojë që përfitojnë pagesa cash të ndihmës ekonomike përzgjidhet aktualisht nëpërmjet një skeme elektronike e ngritur nga Ministria e Shëndetesise dhe Mbrojtja Sociale në zbatim të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, dhe VKM 904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike". Çdo individ apo grup në nevojë aplikon për pagesat CASH brenda 10 ditëve të para të çdo muaji.

Grupi i individëve në nevojë të cilët përftojnë pagesa CASH për aftësi të kufizuar, përcaktohet drejtpërdrejt nga statusi PAK i tyre. Individët marrin statusin PAK me vendim të komisioneve të veçanta të ngritura pranë Instituti të Shëndetit Publik, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social

Shtetëror dhe Insituti i Sigurimeve Shoqërore, në bazë të diagnozës së mjekëve të qëndrave shëndetësore ose spitalit. Nëpërmjet të dhënave nga komisionet, administratorët shoqëror të njësive administrative të Bashkisë Lushnje hartojnë çdo muaj listën e individëve me statusin PAK të cilët duhet të marrin pagesë CASH sipas të njëjtës bazë ligjore si më sipër; kjo listë paraqitet në formë projekt-vendimi për miratim në Këshillin Bashkiak, si dhe për konfirmim në Prefekturë.

Fondi për pagesat CASH i transferohet Bashkisë Lushnje nga Ministria e Shëndetesise dhe Mbrojtja Sociale. Pagesat u shpërndahen përfituesve çdo muaj, nëmpërmjet sistemit bankar.

Bashkia ndeshet shpesh me raste individësh dhe familjesh në nevojë që nuk përzgjidhen për t'u trajtuar nga skema elektronike e Ndihmës Ekonomike, por të cilët Insituti i Shërbimit Social i vlerëson gjithsesi si grupe në nevojë, pavarësisht rezultatit të skemës, duke u bazuar tek legjislacioni në fuqi, por edhe nisur nga përvoja e drejtpërdrejtë e saj.

Në qendrën e përkujdesit social aktualisht mblidhen të dhëna administrative nga punonjësit e kësaj qendre dhe përditësohen në mënyrë të rregullt në bazën e të dhënave në Microsoft Office EXCEL. Këto janë të dhëna të lidhura me veprimtarinë e qendrës: mbi ***përfituesit e shërbimit***, të ndarë sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit PAK e statusit jetim, ***mbi personelin*** që jep shërbimin, dhe të dhëna ***financiare.***

6.3 Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Lushnje përgatit një raport mujor mbi përfituesit dhe fondin e shpenzuar të pagesave CASH të ndihmës ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuar, i cili dërgohet pranë Prefekturës Fier, dhe çdo dy muaj pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Gjendja aktuale e fushës së mbrojtjes sociale – në drejtim të zbutjes së varfërisë – monitorohet në bazë të (i) këtyre të dhënave nëpërmjet bashkëpunimit të rregullt me grupin e aktorëve. Prej këtij procesi monitorimi, administratorët shoqërorë dhe specialistët pranë Drejtorisë vlerësojnë nevojën për të trajtuar me ndihmë ekonomike grupe shtesë të individëve dhe familjeve që mbeten jashtë skemës, dhe parashikojnë fondin shtesë vjetor nga të ardhurat vendore. Vlerësimi kryhet në bazë të (i) disa kritereve, ekzistuese që para bazës së re ligjore, sipas VKM 904, datë 12.12.2012.

Në procesin e hartimit të politikave vendore në drejtim të mbrojtjes sociale, është shumë i rëndësishëm monitorimi i të dhënave për individët të cilët, marrin ndihmë ekonomike dhe, njëkohësisht, përfshihen në programe të tregut aktiv të punës. Organizimi i programeve të tregut

aktiv të punës kryhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ndërsa është jashtë funksioneve të bashkive; megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet tyre ekziston, por marrëdhënia nuk është me bazë të rregullt dhe, për pasojë, nuk lejon shkëmbin të vazhdueshëm të të dhënave për qëllim monitorimi e vlerësimi.

Në Bashkinë Lushnje aktualisht mungon një sistem monitorimi dhe vlerësimi në fushën e nevojave bazë dhe, veçanërisht, të strehimit social, ndonëse aplikimet e individëve e familjeve në nevojë janë një burim kyç dhe i vazhdueshëm i të dhënave për këtë fushë, jo vetëm administrative, por dhe të treguesve të saj. Këto to dhëna përdoren nga Drejtoria e Shërbimit Social për të shpërndarë fondin qendror ose vendor të strehimit social ndërmjet aplikuesve që mbërrijnë në Zyrën e Informacionit të Bashkisë, dhe përmes një analize të tyre është e mundur të vlerësohet efektiviteti i programeve të ofruara dhe të përftohet një pasqyrë e kategorive të përfituesve nga strehimi social; por ky sistem mbetet i bazuar në kërkesë (aplikuesit) ndërsa nuk parashikon analizë të nevojës për strehim jashtë kufizimeve të ofertës (programeve sociale të strehimit). Për pasojë, Bashkia nuk e ka të mundur të vlerësojë nevojat për strehim social të grupeve më të varfëra, të cilat nuk kanë mundësinë të aplikojnë ose të përfitojnë nga programet ekzistuese. Ky gjithashtu, nuk është një problem i cili prek vetëm Bashkinë Lushnje, por shqetësimi ekziston në nivel kombëtar, i përcaktuar dhe në Strategjinë e Strehimit Social 2016-2025.[2]

Gjendja aktuale

Në bashkinë e Lushnjes, në vitin 2021, janë trajtuar me ndihmë ekonomike 545 familje, 1 fëmijë me statusin e jetimit, 3 raste trinjakësh, 10 fëmijë normal në shërbim kujdestarie, 2 fëmijë me AK në shërbim kujdestarie dhe 47 raste dhune. Në vitin 2021, kanë përfituar pagesë për aftësi të kufizuar 1559 invalidë PAK dhe 205 kujdestarë përkatës, 452 të verbër dhe 125 kujdestarë përkatës, 253 individë paraplegjik dhe 251 kujdestarë përkatës, si dhe 2020 invalidë pune.

Shoqata e të Verbërve Shqiptar është një organizatë jo-qeveritare objekt i së cilës është mbrojtja e të drejtave të të verbërve në Shqipëri. Ndër këto probleme nënvijëzohet mungesa e sinjalistikës zanore në hapësirat publike, duke vështirësuar lëvizjen e tyre, frekuentimin e këtyre hapësirave, e institucioneve, etj. e për pasojë, duke i veçuar ata nga shoqëria.

Shoqata e Invalidëve është një tjetër organizatë jo-qeveritare objekt i së cilës janë njerëz invalid të kategorive të ndryshme. Problematika kryesore e ngritur nga kjo shoqatë është mungesa e infrastrukturës së përshtatshme në shkolla , në qëndra shëndetësore si dhe në hapësirat publike.

Nevojat bazë

Në Strategjinë Kombëtare të Strehimit Social 2016-2025[4], strehimi social përkufizohet një alternativë strehimi që mund të ofrojë dhënien me qira ose pronësinë e banesës, e cila ofrohet nga qeverisja vendore ose sektori privat për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të blejnë një shtëpi me çmimet e tregut dhe/ose për familjet e përjashtuara nga tregu i banesave për shkak të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim. Financimi ofrohet nga qeverisja qendrore dhe mund të plotësohet nga buxhetet e qeverisjes vendore. Përveç kësaj, agjencitë (gjysmë) shtetërore, si Enti Kombëtar i Banesave, ofrojnë masa të tjera financimi për të plotësuar strehimin social.

6.4 Organizimi i shërbimit të strehimit social

Strehimi social në Bashkinë Lushnje ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Social,. Buxheti përkatës kalon përmes Drejtorisë së Shërbimit Social. Bashkia Lushnje ofron aktualisht disa programe të strehimit social për të cilët familjet ose individët mund të aplikojnë, si për shembull:

1. Për ***bonus strehimi*** që përfitojnë të gjithë ato familje që kanë në përbërjen e tyre familjare nga një anëtarë invalid, jetim, rom, egjiptian etj. Bonusi i strehimit i referohet vetëm banesave sociale me qera dhe konsiston në likujdimin e 50 % të vlerës së qerasë së banesës të kësaj kategorie e cila financohet nga buxheti i shtetit përmes së Ministrisë Financave dhe Ekonomisë

2. Për ***grantin e menjëhershëm*** për strehim të gjithë ato familje që kanë në përbërjen e tyre familjare nga një anëtarë invalid, jetim, rom, egjiptian etj. Granti i menjëhershëm për strehim konsiston në likujdimin e 10 % -20 % të vlerës së banesës me kosto të ulët të kësaj kategorie e cila financohet nga buxheti i shtetit.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Familje dhe individë në nevojë kryejnë aplikim për strehim social në çdonjërin prej programeve të ofruara nga Bashkia, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së Informacionit të Bashkisë Lushnje. Nëpërmjet një formulari të posaçëm, i cili është pjesë e këtij dokumentacioni, prej aplikantëve mblidhet informacion mbi:

(i) nivelin e të ardhurave të tyre, si dhe

(ii) kategorinë e grupeve në nevojë së cilës ata i përkasin: invalid, kryefamiljare, PAK, fëmijë jetim etj.

Ndër kategoritë ligjore të grupeve në nevojë, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë në gjendje të identifikohen si të tillë gjatë aplikimit për strehim social duke qenë se ende nuk ekziston një formë ligjore përmes së cilës të njihen anëtarët e këtyre grupeve etnike. Në fakt, ky nuk është një problem i kufizuar vetëm për strehimin social dhe fushës së përmbushjes së nevojave bazë, porse ndërlidhet me secilën fushë të përfshirjes sociale.
Të dhënat nga aplikimet e individëve dhe familjeve janë bazë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për programe që financohen me buxhet vendor, dhe për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për programe që financohen me buxhet qendror. Regjistrimi i aplikuesve kryhet çdo ditë, në bazën e të dhënave në Microsoft Office EXCEL.

6.5 Strehimi

Përqindja e personave që nuk kishin asnjë strehim, në raport me popullatën e përgjithshme. Bën të mundur të kuptohet shtrirja e përvojës së mungesës së strehimit, sidomos ndër personat që janë në gjendje strehimi të pasigurtë, strehim kolektiv, strehim ndër miq e të afërm, apo me status të paligjshëm.

Bashkia Lushnje aktualisht paraqet një numër prej 74 famijesh të cilët kanë aplikuar për programin social “Bonus Qeraje”

Strehimi është një fushë problematike në bashkinë Lushnje, kryesisht për arsye të një numri të madh familjesh të cilat kanë qenë vendosur prej vitesh në mënyrë të paligjshme në banesa jo në pronësi të tyre; me kthimin e këtyre banesave pronarëve të ligjshëm, këto familje mbetën të pastreha. Për rrjedhojë fusha është prej vitesh përparësi e bashkisë.

Me gjithë numrin jo të vogël të programeve për strehim social që ofrohen aktualisht me buxhet vendor ose qëndror, mundësia financiare e familjeve ose individëve të varfër nuk i lejon përzgjedhjen në asnjë prej tyre, pra grupet më në nevojë për këtë shërbim social mbeten të përjashtuar. Kjo nuk është problematikë e kufizuar vetëm në bashkinë Lushnje; çështja prek fushën e strehimit social në përgjithësi në vendin tonë, dhe trajtohet me përparësi në Strategjinë e Strehimit Social 2016-2025[4].

7. ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

Në këtë fushë *arsimi* i referohet arsimit parauniversitar, i cili, sipas përkufizimit në Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020[5], përfshin tre nivele: arsimin parashkollor, arsimin bazë (fillor dhe i mesëm i ulët) dhe arsimin e mesëm; ndërsa *arsimi profesional*, sipas Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020[6], funksionon në tre nivele duke i ofruar nxënësve formim të përgjithshëm (teorik dhe praktik), si dhe përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm.:

1. Niveli i parë, i cili përgatit punëtorë gjysëm të aftësuar, të cilët mund të hyjnë në tregun e punës;
2. Niveli i dytë, i cili përgatit teknikë, të cilët gjithashtu mund të hyjnë në tregun e punës;
3. Niveli i tretë, pas të cilit jepet mundësia e vazhdimit të studimeve universitare ose hyrjes në tregun e punës.

7.1 Organizimi i shërbimit të arsimit dhe arsimit profesional

Në fushën e arsimit parauniversitar, në Bashkinë e Lushnjes, aktori kryesor është Drejtoria Arsimore Rajonale[7], e cila është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore në nivel qarku. DAR zbaton Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, ndërsa siguron mjetet arsimore për institucionet arsimore publike, sipas formulës "për nxënës" dhe mbështet qeverinë vendore në planifikimin, realizimin e investimeve në infrastrukturën arsimore, si dhe mirëmbajtjen e saj. Gjithashtu, DAR ka rol në cilësinë e arsimit parauniversitar nëpërmjet dhënies së shpërblimeve për punonjës të institucioneve arsimore publike me arritje të shquara dhe dhënies së bursave të studimit për një numër të përzgjedhur nxënësish, me anë të një fondi të veçantë të buxhetit vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Arsimi profesional është fushë me varësi direkte nga Ministria e ekonomisë dhe Finanacës, pra nuk përfshihet në funksonet ligjore të bashkive. Në vendin tonë arsimi profesional (AFP)[8] ofrohet nëpërmjet shkollës profesionale .

---

[4] *Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, fq.19-20*
[5] *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, fq. 14-15*
[6] *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, fq 19*
[7] *Burimi i të dhënave të këtij paragarafi është Drejtoria Arsimore Rajonale, me përjashtim të rasteve kur burimi specifikohet.*
[8] *Arsimi dhe Formimi Profesional*

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Burimet kryesore të të dhënave për ZAP janë institucionet e mëposhtme: *shkollat, drejtoritë e policisë, qendrat shëndetësore, bashkia, prefektura, qarku, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.* Instrumentet e përdorur për mbledhjen e të dhënave janë: pyetësorë, anketime, formularë. Të dhënat e mbledhura konsolidohen në një bazë të dhënash, e cila është e katogorizuar qartësisht sipas treguesve.

Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale

Problematikat e arsimit në territorin e Bashkisë Lushnje shqyrtohen nga ZAP në bashkëpunim të ngushtë me një numër të gjerë institucionesh vendore, rajonale e qendrore ; të tilla janë rastet e braktisjes së hershme të shkollës nga fëmijët, analfabetizmit, etj.
Të dhënat që merren nga shkollat i përcillen çdo muaj Bashkisë (ose Prefekturës, Qarkut, Policisë etj). Monitorimi i të dhënave në fushën e arsimit kryhet në mënyrë mujore, tre mujore dhe vjetore. Monitorime në terren nuk kryhen rregullisht, por sipas nevojave.

Gjendja aktuale

Në vijim jepen tregues të arsimit në Bashkinë Lushnje me të cilat punon aktualisht ZAP.

Tabela 1.Numri i femijeve sipas nivelit te edukimit parauniversitar, viti 2021

Treguesit	**Publiku**	**Privati**	**Gjithsej**
Numri i fëmijëve në arsimin parashkollor	1969	207	2176
Numri i fëmijëve në arsimin baze	6284	470	6754
Numri i fëmijëve në arsimin e mesëm	2285	296	2581

Burimi:Zyra Arsimore Lushnje,Qëndra e Arsimit në Bashkine Lushnje

Tabela 2. Numri i nxënësve braktises së shkollave, viti 2021-2022

Nxënës braktisës së shkollës	Femra	Qyteti	Fshati	Gjithsej
Cikli fillor	2	3	1	4
Arsimi i mesëm i ulët	3	4	5	9

Burimi: Zyra Arsimore Lushnje

Tabela 4. Informacion mbi nxenesit Rom dhe Egjiptiane

Klasa	Rom	Egjyptian	Braktisës Rom	Braktisës Egjyptian
I	6	20	2	0
II	8	21	0	1
III	8	15	0	0
IV	3	19	0	0
V	9	15	12	2
VI	7	22	0	1
VII	7	14	3	0
VII	6	8	0	0
IX	4	0	0	0
Totali	**58**	**134**	**17**	**4**

Burimi:Zyra Arsimore Lushnje

Table 4. Numri i nxënësve që marrin bursa, 2020

	Nxënës
Numri i nxënësve që përfitojnë bursë studimi	70 nxënës të shkollave të mesme profesinale

Burimi: Zyra Arsimore Lushnje

Një tjetër çështje në lidhje me cilësinë e arsimit është fenomeni i klasave kolektive, i ngritur dhe më parë në studime të ngjashme të ndërmarra nga UNDP dhe organet shtetërore, i cili i referohet kryerjes së orëve të mësimit duke bashkuar nxënës të klasave të ndryshme dhe moshave të ndryshme sëbashku; fenomeni prek arsimin 9-vjeçar. Në Bashkinë Lushnje, Zyra Arsimore Lushnje identifikon mësimin në klasa kolektive në shkolla të vendosura në rajonet më periferike të saj, pra në njësitë administrative.

- Infrastruktura e institucioneve arsimore për personat me aftësi të kufizuar mungon pjesërisht në bashkinë Lushnjes, duke veçuar këtu ndërtesat ekzistuese. Shqetësimi ngrihet nga Shoqata PAK por gjithashtu dhe nga vetë Drejtoria e Shërbimit Social. Në këtë drejtim ka përpjekje për të përfshirë infrastrukturën e nevojshme për personat me statusin PAK në ndërtimet e reja.

8. PUNËSIMI DHE AFTËSITË

8.1 Organizimi i shërbimit të punësimit dhe aftësisë

Punësimi dhe aftësitë është gjithashtu një fushë ku qeveria vendore ka mundësi ndikimi jo të drejtpërdrejtë dhe të kufizuar. Institucioni kryesor i cili mbulon fushën e punësimit dhe aftësitë është Zyra e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Lushnje[9], me varësi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila synon të nxisë një treg pune konkurues, efiçent dhe fleksibël për të ndihmuar punëkërkuesit në gjetjen e punës, veçanërisht grupet në nevojë. ZSHKP ndërmerr programe të nxitjes së punësimit 2 herë në muaj. Gjithashtu përmes këtij institucioni, Ministria e Financave dhe Ekonomisë paguan përfitimet për të papunët, te cilëve u lind e drejta në bazë të legjislacionit në fuqi.

Bashkia Lushnje bashkëpunon me ZSHKP Lushnje për organizimin e panaireve të punës, me fokus të veçantë femrat e trafikuara, femrat e dhunuara, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuar, dhe për të rinjtë.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Treguesit për të cilët Zyra e Punësimit Lushnje mbledh të dhëna janë të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Të dhënat në lidhje me papunësinë në Bashkinë Lushnje mblidhen drejtpërdrejtë nga individët që paraqiten pranë ZSHKP si punëkërkues. Ato hidhen në një sistem informatik, të ndara sipas njësive administrative.

Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale

Përpunimi i të dhënave në ZSHKP kryhet me metoda sasiore të cilat përfshijnë analizën krahasuese të treguesve për periudha kohore të ndryshme. Gjithashtu, përdoren metoda cilësore, si pyetësorë, kryesisht për të marrë nivelin e kënaqshmërisë së individëve që përftojnë shërbime pranë

institucionit. Frekuenca e përditësimit të të dhënave është çdo muaj, ndërsa raportohen sa herë që kërkohen nga institucione të tjera bashkëpunuese.

Gjendja aktuale e punësimit

Norma e papunësisë e raportuar nga ZSHKP duhet interpretuar me shumë kujdes, pasi përftohet mbi bazën e vetëm atyre individëve që regjistrohen si të papunë pranë këtij institucioni, por numri i individëve që kërkojnë punë por jo përmes ZSHKP mund të jetë ndjeshëm më i lartë; një mospërputhje e tillë nuk kufizohet vetëm për bashkinë Lushnje por vërehet në përgjithësi në të gjithë Shqipërinë.

Numri total i punëkërkuesve duke përfshirë rajonet dhe Njësitë Administrative është 1553.

Tabelë 1: **Numri i punëkërkuesve të regjistruar**

	Lushnje	Njesia Administrative Allkaj	Njesia Administrative Dushk	Njesia Administrative Bubullimë	Njesia Administrative Golem	Njesia Administrative Ballagat	Njesia Administrative Fiershegan	Njesia Administrativ e Kolonjë	Njesia Administrative Krutje	Njesia Administrative Karbunar	Njesia Administrative Hyzgjokaj
Gjithesej	740	62	91	44	160	76	50	44	74	100	87
Përfitojne pagesë papunësie	73	0	3	0	3	0	0	6	2	3	0
Qe përfitojn ndihme ekonomike	211	6	28	2	44	19	0	1	4	1	3
Të tjerë	422	16	25	10	47	20	8	7	10	11	3

Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Tabelë 2: **Numëri i punëkërsuesëve sipas profesioneve të regjistruar si punë kërkues pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Lushnje për Bashkinë Lushnje dhe Divjakë**

Profesione	**Lushnje\ Divjakë**
Specialist me arsimë të lartë	685
Teknikë dhe specialistë të mesëm	234
Nënpunës	87
Punojse të shitjeve dhe të shërbimeve	1956
Punojsë të kualifikuar në buqësi	147
Zejtarë zanatcinjë dhe profesione të lidhura me ndërtimin	1982
Punonjës në industri	2541
Profesione elementare	3218
Pa profesion	3977


Burimi i të dhënave të këtij paragarafi është Zyra Rajonale e Punësimit

Tabele 3 : Numri i punëkërkuesve të regjistruar sipas skemes se ndihmes sociale

Punëkërkues të papunë	Gjithsej
Pagesë Papunësie	13
Ndihmë ekonomike	9
Ish përfitues Ndihme ekonomike	6
Skema të tjera	121


Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Grafiku 1: Numri i punëkërkuesve të regjistruar sipas skemes se ndihmes sociale 2021



Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Grafiku 2: Numri i punëkërkuesve të regjistruar sipas skemes se ndihmes sociale 2021




Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Tabele 4: Numri i punëkërkuesve sipas kualifikimeve

	gjithsej	Femra
Kualifikim të ulët	1417	766
Kualifikim të mesëm dhe professional	1164	664
Kualifikim të lartë	289	173


Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Grafiku 3: Numri i punëkërkuesve sipas moshës Femra



Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

Grafiku 4: Numri i punëkërkuesve sipas kualifikimit arsimor Femra



Burimi: Zyra e punesimit Lushnje

9. PJESËMARRJA SOCIALE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Nisur nga grupi i treguesve të kësaj fushe të paraqitur në Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020[10], fusha e pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut përmbledh grupin e elementëve si më poshtë:

1. Zotërimi i dokumenteve personale
2. Pjesëmarrja kulturore
3. Pjesëmarrje politike
4. Dialogu me organizatat e shoqërisë civile
5. Qasja në drejtësi

9.1 Organizimi i shërbimit për pjesëmarrjen sociale dhe të drejtat e njeriut

Fusha e pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut mbulohet në Bashkinë Lushnje në këto drejtime kryesore të saj: regjistrimi civil i fëmijëve, barazia gjinore, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e të drejtave të personave LGBT, dhe organizimi i veprimtarive social-kulturore.

Regjistrimi civil

Qendra TLAS është një organizatë jo-qeveritare aktive në regjistrimin civil të grupeve të veçanta të popullsisë së bashkisë Lushnje, kryesisht të fëmijëve të cilët, në varësi të rrethanave, kanë vështirësi ligjore për tu regjistruar në kopshte, shkolla etj.; i tillë është rasti i fëmijëve të lindur jashtë vendit.

Barazia gjinore

Në kuadër të zbatimit të projektit “Ndërtimi i nje sistemi referimi te qëndrueshëm për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel lokal”, Bashkia Lushnje në bashkëpunim me organizatën Refleksione është krijuar Zyra e parë për Barazinë Gjinore në vitin 2011.
Zyra e Barazisë gjinore dhe Dhunës në Familje punon për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi problemet gjinore me të cilat përballet shoqëria sot, për promovimin dhe mbështetjen e grave në politikë, për të nxitur zbatimi e politikave lokale gjinore dhe për të kontribuar në adresimin e nevojave të grupeve më pak të perfaqesuar, siç janë gratë si dhe në menaxhimin dhe koordinimin e punës për rastet e dhunës në familje.
Shoqata e Grave si promotore e lëvizjes së gruas në nivel vendor vepron ngushtë me Zyrën e Barazisë Gjinore pranë Bashkisë në këto drejtime.

OKB dhe UNDP janë organizata të cilat mbështesin Bashkinë Lushnje në fushën e pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut, me fonde financiare por edhe konsulencë profesionale. Me mbështetjen e këtyre organizatave është ngritur Platforma Strategjike për Reagim të Koordinuar të Komunitetit kunder Dhunës në Familje në Lushnje" (CCR).Institucionet e përfshira renditen në vijim:

Zyra për Barazinë Gjinore dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijeve, Bashkia Lushnjes,
Drejtoria e Policisë
Drejtoria Arsimore Rajonale
Prokuroria e Rrethit Lushnje
Gjykata e Shkallës së Parë
Drejtoria e Shëndetit Publik
Spitali Rajonal Lushnje
Drejtoria Rajonale e Punësimit
Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore
Institucionet Fetare
Shoqata e Grave me Probleme Sociale

9.2 Treguesit socialë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë Lushnje

Duke marrë në konsideratë reformën territoriale, kapacitetet e Bashkisë si dhe OJF-të që veprojnë në zonën e Lushnjes, mund të identifikohen disa sfida dhe nevoja prioritare në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për mbrojtne e fëmijëve në këtë bashki:

- Aktualisht, Bashkia ofron shumë pak shërbime, edhe ato më shumënë formën e mbështetjes sesa shërbime të ofruara në mënyrë të drejpërdrejtë prej saj. Numri i OJF-ve tëangazhuara në Lushnje është gjithashtu i kufizuar, ndërkohë që nevojat e komunitetit janë shumë diverse dhe shpesh të kthyera në problematika të thella.
- Është e domosdoshme tëngrihen qendra sociale për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe të krijohen mundësi që stafi të mund të ndjekë rastet që kanë nevojë për vizita/shërbime në shtëpi.
- Është e domosdoshme të hartohen përshkrime të plota pune për pozicionet e stafit të angazhuar me shërbimet sociale për të rritur qartësinë e roleve, mirë-koordinimin e burimeve njerëzore, si dhe mundësinë për llogaridhënie e matje të performancës.
- Qasja e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të ndryshojë. Është i domosdoshëm kalimi nga thjesht ofrimi i ndihmës ekonomike kesh për familjen, tek fokusimi te individi dhe

nevojat e tij në mënyrë integrale, gjë që kërkon një menaxhim të integruar të rasteve dhe qasje multidisiplinare. Për shembull, në adresimin e dhunë në familje apo të mbrojtjes së fëmijës, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizmi kundër dhunës duhet të jetë që të dy operacionalë dhe të punojnë si një skuadër, duke shtuar edhe anëtarë (profesionistë) të tjerë sipas nevojës.

- Procedurat e blerjes së shërbimeve shtesë në lidhje me nevojat për kujdesin shoqëror nga palët e treta përmes prokurimit janë të paeksperiementuara më parë në fushën e shërbime sociale, ndaj është e domosdoshme të ndërtohen procedura dhe praktika në këtë drejtim. Bashkia dhe njësitë administrative kanë nevojë për një buxhet të caktuar që ta përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për t'iu përgjigjur në kohë nevojave emergjente për shembull të fëmijëve në rrezik abuzimi, fëmijëve në situatë rruge, fëmijëve të braktisur.
- Duke iu referuar gjendjes aktuale, bashkisë dhe njësive administrative iu mungon infrastruktura e nevojshme që të sigurojnë shërbimet e kujdesit social në kohë dhe me cilësi. Mungesa e transportit pengon dhënien e përgjigjes në kohë për rastin e identifikuar nga punonjësit e terrenit. Gjithashtu, shumë njësi administrative nuk kanë hapësirë të përshtatshme për kryerjen e punës me rastet sipas standardeve të përcaktuara. Kjo cenon, ndër të tjera, edhe cilësinë e punës në njësinë bazë, nga mbingarkesat e krijuara si pasoje e delegimit të cdo rasti të identifikuar në njësinë qendrore (si p.sh. në rastin e punës së NjMF-së).

Misioni, vizioni, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e planit social per mbrojtjen e femijeve ne bashkine Lushnje

Misioni

Bashkia e Lushnjes synon të konsolidojë sektorin e shërbimeve sociale ne fushen e mbrojtes se femijeve dhe të ofrojë më shumë mbështetje dhe shërbime sociale për ta duke maksimizuar eficiencën e përdorimit të burimeve dhe kapaciteteve njerëzore në realizimin sa me të plotë të objektivave të vendosur.

Vizioni

Shërbimet sociale per mbrojtjen e femijeve në Lushnje janë të larmishme, në përputhje me nevojat e komunitetit, me standarde, të besueshme dhe pranë njerëzve. Nevojat e femijeve të Bashkisë janë të njohura, të vlerësuara dhe të dhënat e tyre ushqejnë planifikimin dhe zbatimin e politikave sociale të Bashkisë.

[10] *Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale, 2016-2020, fq. 82*

Bashkia maksimizon eficiencën e përdorimit të burimeve për një mbulim sa më të mirë të nevojave materiale të tyre, si dhe një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror, sipas një qasjeje me personin në qendër, multisektoriale dhe të menaxhimit të rastit.

Qëllimi 1 – Ngritja/zhvillimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve

- **Objektivi 1 – Ngritja e Njësive të Mbrojtjes së fëmijëve në bashki/NJA**
    - **Aktivitete**:Ndërtimi i strukturës së NJMF-së në bashki/NJA; diskutimi dhe miratimi i pershkrimeve te punes per NJMF/PMF.

- **Objektivi 2 – Forcimi i koordinimit/qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në bashki/NJA**
    - **Aktivitete:** Ngritja e GTN, Integrimi i NJMF-ve NJVNR, Krijimi dhe përditësimi i hartës lokale dhe adresarit të shërbimeve/projekteve vendore për fëmijë dhe familje

- **Objektivi 3 – Ngritja e strukturës së supervizimit në bashki**
    - **Aktivitete:** Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i supervizimit në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, Zbatimi i procedurave të supervizimit dhe roleve e përgjegjësive të supervizuesit e të supervizuarit

Qëllimi 2 – Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja për mbrojtjen e fëmijëve

- **Objektivi 1 - Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje**
    - **Aktivitete:** Prezantimi dhe vënia në dispozicion të të gjithë profesionistëve/institucioneve përgjegjëse i të gjitha formave të dokumentimit për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe me detyrimet ligjore përkatëse; ngritja e skuadrave të terrenit.

- **Objektivi 2 – Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje**
    - **Aktivitete:** Ofrimi i shërbimit 24 orësh për përgjigjen ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Qëllimi 3 – Ndërgjegjësimi institucional e komunitar për mbrojtjen e fëmijëve

- **Objektivi 1 – Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve**
    - **Aktiviteti:** Aktivitete informuese me komunitetin dhe institucionet publike mbi rendesine e mbrojtes se femijeve.

Qëllimi 4 – Rritja e kapaciteteve organizative të bashkisë për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve

- **Objektivi 1 – Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin, monitorimin dhe raportimin e mbrojtjes së fëmijëve**
    - **Aktivitete –** Trajnime mbi mbledhjen, përpunimin e të dhënave; Trajnime për përdorimin e evidencave në vendimmarrje/planifikim etj.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve

Në Bashkinë Lushnje është e ngritur njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, e cila është e përbërë nga tre nëpunës të cilët shqyrtojnë raste të abuzimeve me fëmijët, dhunës, shfrytëzimit për qëllime përfitimi ekonomik apo forma të tjera të shkeljes së të drejtave të tyre. Njësia vepron në terren përmes skuadrave të përbëra nga përfaqësues të organizatave jo qeveritare të cilat kanë të njëjtin objektiv.

Veprimtari të rëndësishme kanë gjithashtu organizata jo qeveritare të cilat bashkëpunojnë me bashkinë në zbatimin e projekteve të ndryshme në qytet. Kryesisht këto organizata janë të pozicionuara në zona të ndryshme veprimi, gjë që bën më të lehtë veprimin e tyre dhe gjithashtu trajtohen problematika të ndryshme në të gjithë zonën e Bashkisë Lushnje.

Bashkia e Lushnjes ka rritur mbështetjen e saj për disa aktorë të shoqërisë civile vendore, duke përfshirë OJF që ofrojnë shërbime sociale për grupet në nevojë si fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit.

Në një bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjes dhe disa Shoqata ofrohen shërbime psikologjike dhe psikoedukative për fëmijë që janë të ekspozuar ndaj dhunës në familje, janë fëmijë jetim, të braktisur dhe të varfër. Gjithashtu punohet edhe me prindër të këtyre fëmijëve për t'i ndihmuar të mbrojnë fëmijët nga dhuna. Fëmijë e prindër asistohen përmes këshillimeve psikologjike dhe aktiviteteve psikoedukative për të ndihmuar prindërimin, për menaxhimin emocional dhe edukimin e përshtatshëm të fëmijëve.

Mbrojtja e të drejtave të personave LGBT

Bashkia Lushnje vepron në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave LGBT kryesisht nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe trajnimeve të organizuara me nismën e Ambasadës PINK dhe mbështetjes së CRCA dhe Ambasadës PINK. Veprimtaria është gjithsesi e lidhur ngushtë me projekte të këtyre organizatave të shoqërisë civile dhe kufizohet në harkun kohor të zbatimit të tyre.

Veprimtari social-kulturore

Bashkia organizon aktivitete kulturore me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes sociale të individëve e grupeve në nevojë në bazë të një kalendari të paracaktuar. Komuniteti rom e egjiptian, gratë kryefamiljare apo familjet të cilat mbështeten në ndihmë ekonomike janë kategoritë kryesore të cilat vendosen në vëmendje përmes këtyre veprimtarive.

Përmbushja me sukses e qëllimit të tyre është e varur nga koha dhe shkalla e informimit të individëve e grupeve të synuara nga ana e Bashkisë; shpesh informacioni për organizimin e veprimtarive merret me vonesë ose nuk shtrihet mjaftueshëm për të arritur tek një numër më i madhe njerëzish. Në fakt veprimtari të tilla nuk organizohen në bazë të objektivave specifikë për shkallën e dëshiruar të ndikimit, në njësi banorësh, apo sipërfaqeje.

10. SHËNDETËSIA

10.1 Organizimi i shërbimit të shëndetësisë

Në fushën e shëndetësisë funksioni ligjor i njësive të qeverisjes vendore shtrihet vetëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimit të kujdesit parësor. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier është institucioni kryesor i cili mbulon këtë fushë në Bashkinë Lushnje. Nga kjo drejtori ofrohen aktualisht shërbimet si më poshtë:

1. Shërbimi i Epidemiologjisë,
2. Shërbimi i Shëndetit Mjekësor,
3. Shërbimi i Mjekësisë Familjare,
4. Shërbimi i Stomatologjisë,
5. Shërbimi Psiko-social dhe i Shëndetit Mendor.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

ISHP Lushnje është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të bashkisë sipas treguesve të mësipërm, analizën dhe monitorimin e vlerësimin tyre. Institucionet nga burojnë të dhënat janë: Qëndrat shëndetësore dhe Spitali Rajonal Lushnje . Instrumentet e përdorur për mbledhjen e të dhënave janë formularë (që vijnë në rrugë elektronike ose të printuar). Sipas formularëve të ndryshëm, përdoren metoda sasiore dhe cilësore të analizës së të dhënave që ata përmbajnë.

Në kuadër të platformës së bashkëpunimit mes Bashkisë dhe DRSH Fier janë hartuar *tre formularë* për shkëmbimin e informacionit shëndetësor ndërmjet *qendrave shëndetësore* dhe *njësive administrative* të bashkisë. Ky është informacion mbi individë me shqetësime shëndetësore të cilët i përkasin njëkohësisht një kategorie në nevojë: individë që marrin ndihmë ekonomike, gra kryefamiljare, PAK, etj., i cili i kalohet Bashkisë me qëllimin për të dhënë mbrojtjeje sociale.

Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale

Platforma e bashkëpunimit Bashki-DSH përbën në vetvete një përpjekje për të ngritur një sistem monitorimi dhe vlerësimi të gjendjes së shërbimit shëndetësor në Bashkinë Lushnje, mbi bazën e informacionit të të cilit, DSH dhe Këshilli Bashkiak mund të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të cilat dalin jashtë kompetencave dhe kapaciteteve të qendrave shëndetësore dhe administratorëve social të njësive administrative.

11. DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtoria e Shërbimit Social ka si mision:

1. Të evidentojë grupet në nevojë brenda territorit të bashkisë dhe të krijojë, brenda kuadrit ligjor, kushtet e favorshme për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur social familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar;
2. Të përgatisë çdo fundmuaji projektvendimin përkatës për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë me listat bashkangjitur, të cilat përgatiten në katër kopje dhe dërgohen në Këshillin Bashkiak për miratim;
3. Të hartojë programe veprimi afatmesëm dhe afatgjatë, në zbatim të strategjive kombëtare dhe

vendore, për zbutjen e varfërisë, integrimin e pakicave, implementimin e projekteve publike etj;

4. Të miratojë listat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë;

5. Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për hartimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë.

11.1 Objektivat e Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Lushnje janë si mëposhtëm :

1. Shtrirjen e shërbimeve sociale në gjithë territorin e Bashkisë se re dhe në përputhje të plotë me nevojat e grupeve të margjinalizuara,

2. Ngritjen në nivel vendor të strukturave për vlerësimin periodik të nevojave të grupeve të margjinalizuara dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara,

3. Fuqizimin e kapaciteteve vendore – duke përfshirë dhe OJQ lokale – në ofrimin e shërbimeve sociale dhe koordinimi i aktivitetit te tyre,

4. Ndërtimin e objekteve të reja për të plotësuar kërkesat në rritje të komunitetit,

5. Ndërtimin e apartamenteve për strehimin e shtresave në nevojë,

6. Evidentimin e trojeve që mund të përdoren për programet sociale të strehimit,

7. Evidentimin e objekteve që kanë dalë jashtë funksionit të cilat mund të adaptohen për objekte të strehimit social,

8. Menaxhimi i banesave sociale të dhëna me qera,

9. Aplikimi i kredive te buta për blerje apartamentesh,

Drejtori i Shërbimit Social

Është nëpunës ne varësi të N/Kryetarit të Bashkisë dhe ka për detyrë :

1. Të realizojë drejtimin, organizimin dhe koordinimin e punës për përmbushjen e misionit dhe gjithë detyrave ligjore të drejtorisë;

2. Të mundësojë një partneritet të sigurtë dhe serioz për të gjitha shoqatat dhe institucionet humanitare që, nëpërmjet bashkëpunimit me projekte të përbashkëta, të ndihmojë në uljen e varfërisë në familje dhe individë në nevojë;

3. Të identifikojë burime materiale dhe njerëzore në komunitet për të gjetur mënyra bashkëpunimi për t'iu ardhur në ndihmë grupeve në nevojë të qytetit;

4. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe projekteve të ndryshme sociale;
5. Iu dërgon listat institucioneve, sipas pikës 14 të VKM nr 787, datë 14.12.2005, të specifikuara për secilin institucion, për t'iu shprehur dhe konfirmuar gjendjen dhe ndryshimet në listat e dërguara. Çdo konfirmim për ndryshim i sjellë nga ana e institucioneve iu bëhet i qartë specialistëve përkatës që ta pasqyrojnë ndryshimin në projektin e tyre në materialin që përgatitet për miratim në Këshillin Bashkiak.
6. Përgatit projektvendime "për ndihmën dhe përkrahjen sociale", të cilat i paraqiten për miratim Këshillit Bashkiak dhe ndjek të gjithë relacionet që miratohen prej tij në lidhje me ndihmën dhe shërbimin social;
7. Përgjigjet për përdorimin e fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit dhe zbatimin e standardeve kombëtare të shërbimeve shoqërore, planifikon nevojat e grupeve në nevojë dhe harton kërkesën për fonde pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetërore;
8. Brenda tri ditëve nga vendimmarrja bën zbardhjen e vendimit të Këshillit të Bashkisë dhe ia paraqet sekretarit të Këshillit, për ta nisur tek N/Prefektit për konfirmim;
9. Mban korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të Ndihmës dhe Përkrahjes Shoqërore për problemet që shqetësojnë këtë sektor në territorin e Bashkisë Lushnjë;
10. Vlerëson punën vjetore të vartësve dhe i propozon Kryetarit të Bashkisë masa disiplinore për vartësit që demonstrojnë paaftësi në kryerjen e detyrës ose shkelje të disiplinës në punë.

Specialisti i Ndihmës Ekonomike

Eshte nëpunës me varësi nga Drejtori Shërbimit Social dhe ka si detyrë:
1. Të identifikojë familjet në nevojë për ndihmë ekonomike, të verifikojë gjendjen ekonomike të tyre dhe propozojë në stafin e drejtorisë familjet në nevojë për të përfituar ndihmën ekonomike dhe masën e saj, duke marrë pjesë në hartimin e projekt-vendimit që paraqitet në Këshillin Bashkiak;
2. Të verifikojë gjendjen social-ekonomike të familjeve në nevojë, të cilat janë parashikuar të futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike
3. Të vlerësojë nevojat e individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet e bashkisë dhe grumbullojë informacione për rrjetin e shërbimeve publike e private që veprojnë në territorin e bashkisë, si dhe ndihmojë aplikantët në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
4. T'iu ofrojë qytetarëve konsulencë për legjislacionin dhe procedurat që duhet të ndjekin në zgjidhjen e problemeve të tyre, gjithashtu të sqarojë pretenduesit për ligjin, të drejtat dhe detyrimet që duhet të plotësojnë për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike;

5. Të mirëpresë kërkesat e qytetarëve të cilët pretendojnë ndihmë ekonomike;
6. Specialisti grumbullon informacione dhe harton statistika mbi nevoja që ka drejtoria për shtimin e financimit, në varësi të gjendjes ekonomike dhe numrit të familjve që janë ose duhen shtuar në skemën e ndihmës ekonomike;
7. Përgatit shkresat dhe kërkon informacionet e nevojshme për gjendjen e familjeve apo anëtarëve të saj në institucionet përkatëse si: Zyrën e Punës, Drejtoria e Tatim-Taksave, Zyrën e Sigurimeve Shoqërore, ZRPP (hipoteka), Zyrën e Regjistrimit të Automjeteve, drejtoritë pranë bashkisë dhe përgatit dosjet e trajtimit për çdo familje;
8. Përgatit materialin me shkrim për familjet apo individë që do përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike për muajin pasardhës dhe e trajton në stafin e drejtorisë para dërgimit të tij për miratim në Këshillin Bashkiak;
9. Bën ndryshimet përkatëse sipas vendimit të stafit të drejtorisë dhe përgatit relacionin e projektvendimin për miratimin e tij në mbledhjen e radhës në Këshillin e Bashkisë;
10. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe konfirmimit nga N/Prefekti të listave të ndihmës ekonomike bën afishimin e tyre në vendin e përcaktuar nga bashkia për të gjitha familjet e përfshira në skemën e ndihmës ekonomike.

Specialisti i Njësise për Mbrojtjen e Fëmijëve

Eshte nëpunës me varësi nga Drejtori Shërbimit Social dhe ka si funksion:

1- Identifikimin e fëmijëve në rrezik nëpërmjet informacioneve të siguruara nga vet NJMF-ja, marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, anëtaret e komunitetit, vetë fëmija dhe media;
2- Menaxhimin e rasteve emergjente të femijeve në bashkëpunim me policinë, SHSSH dhe aktorë te tjere të nevojshëm;
3- Ndërrmajen e vlerësimit fillestar për të gjithë rastet e fëmijëve të referuar në NjMF-në;
4- Organizimin e vlerësimeve të thella e të plota për fëmijet e referuar pranë NjMF-së;
5- Koordinimin dhe lehtësimin e takimit të Grupit Teknik Multidisiplinar për të diskutuar për çdo fëmije të konsideruar në rrezik;
6- Zhvillimin dhe shqyrtimin e planeve individuale te fëmijeve në rrezik dhe monitorimin e zbatimit derisa rasti të mbyllet;
7- Denoncimni në polici të rasteve të abuzimit të ndodhur apo supozuar në menyre që të mbrohen fëmijët;
8- Organizimin e punës së drejtëpërdrejtë me fëmijet dhe familjet;

9- Të veproj si Menaxher Rasti dhe te jetë përgjegjës për implementimin dhe monitorimin e planit Individual të Mbrojtjes dhe Përkujdesit edhe në rastet kur fëmija është ne institucion rezidencial ose në çfarëdo lloji strehimi të përkoheshëm;

10- Të mbajë të dhëna të sakta dhe faktike për të gjitha rastet e menaxhuara dhe te referuara të fëmijeve pranë NJMF-së;

11- Paraqet periodikisht pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijeve të dhena statistikore, që ka përpunuar si dhe informacion për situaten e mbrojtjes së fëmijëve në territorin e bashkise.

12- Puna e punonjësit social tëNjësise për Mbrojtjen e Fëmijeve (NJMF), ne bazë të ligjit nr. 18/2017 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijeve" eshte e lidhur ngusht me punën e koordinatorit te dhunes në familje, pasi aty ku ka dhunë ne familje, patjeter qe ka dhune tek të gjithe anëtaret vulnerabël të familjes sidomos fëmijët.

13- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve mbron dhe mbështet fëmijët :

- në nevoje dhe varferi ekstreme;
- fëmije të dhunuar fizikisht/seksualisht/psikologjikisht;
- fëmije me aftësi ndryshe në nevojë;
- fëmije në situatë rruge ;
- Fëmijë të neglizhuar.

Specialistë për Barazin Gjinore dhe Dhunën në Familje

Eshte nëpunës me varësi nga Drejtori Shërbimit Social dhe ka si funksion:

1- Te identifikoj rastet e dhunes ne familje dhe te mbeshtesi viktimat e dhunes deri ne rehabilitimin e tyre.

2- Të asistoj viktimën e dhunes ne familje pranë komisariatit të policise ne momentin e denoncimit te dhunes.

3- Te inicioj urdherin e menjehershem/urdherin e mbrojtjes kundrejt viktimies se dhunes dhe te monitoroj rastin deri ne momentin kur viktima konsiderohet jashtë rreezikut per jeten.

4- Te orientoj viktimen e dhunes ne familje drejt sherbimeve qe ofrohen per rehabilitimin e tyre.

5- Organi prites per viktimat e dhunes ne familje, pergjithesisht eshte Komisariati i Policise Lushnje i cili therret punonjesin social te njesise se mbrojtjes se viktmes te dhunes, per te asistuar viktimen kur merret ne pyetje nga oficeri i policise.

6- Ne rastet kur viktima pajiset me urdher te menjehershem mbrojtjeje apo me urdher

mbrojtje dhe nuk ka mundesi te kthehet ne banesen e saj, se bashku me femijet vendoset ne qendren trazitore te ngritur prej disa muajsh ne Lushnje, qender e cila per 7 dite ofron ushqim, strehim, veshmbathje, kujdes per higjenen, keshillim psikologjik, mbeshtetje psiko-emocionale per femijet ne rrezik dhe familja e tyre ndihmohen te perfitoj nga programet sociale si psh.:

- ndihma ekonomike,
- pagesa per strehimin,
-sistemimi i femijeve ne cerdhe/kopesht/shkolla sipas moshes se femijeve,
-ndermjetesim me biznesin privat, qe keto gra te kene mundesi punesimi, deri ne perpjekjet per te gjetur dhe banese me qera ne menyre qe viktima e dhunes te lehtesohet nga ngarkesa dhe te kete mundesi te rehabilitohet se bashku me femijet.

7- Gjithashtu ne momentin kur urdheri i mbrojtjes vjen zyrtarisht prane zyres se Sherbimit Social, zbatohet menjehere, duke i dhene pagesen prej 3000 leke, viktimes se dhunes ne familje per aq kohe sa urdheri i mbojtjes shtrin efektet e tij.

8- Rasti monitorohet dhe ne vazhdimesi ne baze te ligjit nr. 9669 date 18.12.2006 “Per masat ndaj dhunes ne marredhenie familjare” duke bere vizita familjare ne menyre periodike ne familjen e viktimes se dhunes, duke ofruar keshtu dhe mbeshtetje psiko emocionale per te gjithe anetaret e familjes. Ne cdo rast punonjesi social ka ne vemendje te vecante keto viktima per ti mbeshtetur dhe referuar ne organizata jofitimprurese, qe ofrojne mbeshtejtje me pako ushqimore.

Sektori i Shërbimit Shoqëror dhe Menaxhimi i Rasteve

Eshte sektor me varësi nga Drejtori Shërbimit Social dhe ka si detyrë:

`1. Të evindetojë grupet në nevojë brenda territorit të Bashkisë dhe te krijojë brenda afatit ligjore kushtet e favorshme për t’iu ofruar ndihmen e nevojshme dhe shërbimin e duhur familjeve në nevojë.

2. Të verifikojë gjëndjen social ekonomike të familjeve në nevojë të cilat janë parashikuar të futen për herë të parë në skemen e ndihmës ekonomike.

3. Të vlersojë dhe të orjentojë individët për të marrë shërbimet shoqërore në përputhje me prioritete e Bashkisë.

4. Hedhja e të dhënave statistikore për 15 Njësitë Administrative për NE, PAK dhe Invalid Pune.Dergimi i tyre në Drejtorin Rajonale të Sherbimit Social Shteteror Fier.

5. Plotesimi i regjistrit elektronik per familjet perfituese te NE dhe PAK dhe dergimi i tyre në Drejtorin Rajonale të Sherbimit Social Shteteror Fier

6. Të krijojë kontakte me organizatat qeveritare, jo qeveritare si edhe me bizneset të cilat do të ofrojnë shërbime dhe ndihmesen e tyre per familjet ne nevojë.

7. Të plotësojë formularin e Vlersimit Social për familjet në nevojë dhe ta dërgojë atë në Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror Fier.

8. Të mbajë kontakte të vazhdueshme me Administratorët e çdo Njësie Administrative për çdo problem social që mund të hasin me qytetarët.

9. Të kontrollojë dosjet e Ndihmes ekonomike si dhe të P. A. K ne çdo njësi administarive me grupin e kontrollit të ngritur nga eprori.

10. Të jetë pjesë e grupit të kontrollit të ngritur nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror në njësitë administarive të përcaktuara nga ta.

11. Të informojë isnpektoret e çdo njësie administrative për çdo informacion që vjen nga Drejtoria e Sherbimit Social Shtetëror Fier në lidhje me proçedurat e skemes ekonomike

Specialisti i Personave me Aftësi të Kufizuar (P.A.K)

Eshte nëpunës me varësi nga Drejtori Shërbimit Social dhe ka si detyrë:

1. Nga data 1-15 të çdo muaji kalendarik të punojë Projekt-Vendimet për pagesat e PAK, kujdestarë PAK, Verbëri grupi I dhe grupi II, kujdestarët e verbërisë, Para-tetraplegjiket dhe kujdestarët e Para-tetraplegjikëve. Pas përfundimit të pagesave bëhën përmbledhëset për çdo rajon dhe në fund përmbledhësja përfundimtare që përfshin të 5-ta Rajonet e Bashkisë Lushnje.
2. Të mbledh dosjet e personave me AK nga Njesitë Administrative me Proces Verbal ku përcaktohet *dorëzuesi* dhe *marrësi në dorëzim* dhe t'i dërgojë me shkresë përcjellëse të koceptuar nga drejtori i zyrës dhe firmosur nga N/Kryetari në Kempin Epror (Tiranë) në komisionin për Sëmundjet e Përgjithshme, Para-tetraplegji dhe Verbëri duke i ndarë dosjet në bazë të katëgorisë së sëmundjeve të personave me AK. Shkresa përcjellëse i drejtohet "*Drejtorisë së Komisionimit dhe Menaxhimit Të Rastit*" Zyra e kontrollit të NE dhe AK. Dosjet që dërgohen mund të jenë për herë të parë, për rikomisionim dhe Rinovim Libreze.
3. Të dorëzojë dosjet që kthehen nga Kempi Epror Tiranë Njesive Adminimistrative përkatëse me Proces Verbal ku përcaktohet *dorëzuesi* dhe *marrësi në dorëzim*.
4. Të njoftojë inspektorët e Ndihmës Ekonomike të Njesive Administrative për datat e PAK që do të komisionohen në Kempin Epror Tiranë në mënyrë që qytetarët të paraqiten në datat e caktuara nga Kempi.

5. Të punojë listat e kujdestareve të Para-Tetraplegjikëve, të cilat bëhën çdo 3 muaj dhe bashkangjitur me shkresen përcjellëse dërgohën në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror Fier.
6. Të mbledhë Deklaratat mbi Gjendjen Civile, Vendbanimin dhe Marrëdhëniet e Punës ose Vetëpunësimin nga Njesitë Administrative dhe ti dërgojë në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.
7. T'i dorëzojë Njesive Administartive me process-verbal "*Kthim përgjigjet*" që vijnë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier.
8. Të bashkëpunojë me Gjendjen Civile për të paraqitur në kohë informacionin mbi shtetasit e vdekur dhe para se të punohen Projekt-Vendimet shikohen listat për të hequr shtetasit e vdekur të cilët marrin pagesën e Kempit pranë Drejtorisë sonë.
9. Të marrë pjesë në grupin e kontrollit për dosjet e NE dhe PAK duke kontrolluar dokumentacionet përkatëse dhe afatet e dosjeve.
10. Të sqarojë çdo qytetar që paraqitet në zyrë pranë Drejtorisë, për çdo paqartësi që ka në lidhje me afatet e dosjeve dhe datat e komisionimit në KMCA-p Rajonal dhe Epror si edhe KMPV Tiranë.
11. Të verifikojë familjet me persona me aftësi të kufizuar, të grumbullojë informacion për personat të cilët janë nën shërbimin e një kujdestari dhe të vlerësojë nevojat e këtyre individëve.

Specialisti i Strehimit

1.Te ndjeke zbatimin e kerkesave te ligjit 9232, date 13.05.2004 ndryshuar me ligjin 9719, date 23.04.2007 "Per programet sociale te strehimit te banoreve zonave urbane" dhe aktet e tjera nenligjore ne zbatim te tij, per zgjidhjen e poblemit te strehimit

2.Te hartoje programe afatshkurtra dhe afategjate per zgjidhjen e problemit te strehimit, ti paraqes per diskutim ne Komisionin e Keshillit me pas per miratim ne Keshill

3.Te hartoj informimin e relacione per Kryetarin e Bashkise mbi ecurine e zbatimin e te programit social te strehimit, duke paraqitur ne Keshillin e Bashkise projektvendime per permirsimin dhe nxitjen e rrugezgjidhjeve te strehimit

4.Te pergatise lisdtat e qytetareve te cilet perfitojne nga kontributi I shtetit (Enti Kombetare I Banesave), strehim ose kredi me interesa te uleta dhe beje klasifikimin e plote te aplikanteve sipas kategorive percaktuar ne ligj.

5.Te realizoje korrespondencen per plotesimin e dokumentacionit per kalimin ne fond banese dhe banesa shteterore ente te pa privatizuara.

6.Te beje publikimin ne mediat lokale te gjithe problemet dhe risite ligjore qe kane te bejne me strehimin e familjeve te pastreha

7.Te raportoje ne menyre periodike tek eprori direct, Kryetari i Bashkise dhe ne Keshillin Bashkiak per ecurine dhe inplementimin e programit afatgjate te strehimit.

8. Te informoj qytetaret ne lidhje me programet sociale qe aplikohen ne periudha te caktuara, te miratuara me VKB.

11.2 Të dhëna mbi organizimin dhe kapacitetet e stafit të Bashkisë

Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki është **Drejtoria e Shërbimit Social**. Kjo drejtori ka në përbërje të saj Drejtorin dhe 7 specialistë: (1) Specialist i PAK; (2) Specialist i NE; (3) Specialist per Barazin Gjinore dhe Dhunen ne Familje; (4)Punonjes Social per Sherbimet ne Terren ; (5) Specialist per mbrojtjen e femijeve; (6) Specialisti i Strehimit.

Sipas Rregullores ***kjo Drejtori ka si mision:***

1. *Të evidentojë grupet në nevojë brenda territorit të bashkisë dhe të krijojë, brenda kuadrit ligjor,kushtet e favorshme për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur socialfamiljeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar;*

2. *Të përgatisë çdo fund muaji projektvendimin përkatës për përfituesit e ndihmës ekonomike dhepagesat e paaftësisë me listat bashkangjitur, të cilat përgatiten në katër kopje dhe dërgohen në KëshillinBashkiak për miratim;*

3. *Të hartojë programe veprimi afatmesëm dhe afatgjatë, në zbatim të strategjive kombëtare dhevendore, për zbutjen e varfërisë, integrimin e pakicave, implementimin e projekteve publike etj;*

4. *Të miratojë listat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesat e paaftësisë;*

5. *Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për hartimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmësekonomike dhe pagesat e paaftësisë.*

Detyrat e specialistëve të PAK dhe ndihmës ekonomike[2] duke ju referuar përshkrimit të tyre të punës lidhen drejtpdrejtë me:

- ✓ proceset e aplikimit për përfitimin nga pagesat cash (NE dhe PAK),
- ✓ administrim dokumentacioni,

[2]*Këto detyra janë të njëjta si për specialistin e NE dhe PAK në Drejtori, ashtu dhe në nivelin e njësive administrative*

- ✓ ndërveprim me institucione të tjera që veprojnë në këtë fushë sipas legjislacionit në fuqi,
- ✓ verifikime social-ekonomike të familjeve përfituese të NE.
- ✓ vlerësimin e nevojave të individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet e bashkisë dhe grumbullojë informacione për rrjetin e shërbimeve publike e private që veprojnë në territorin e bashkisë, si dhe ndihmojë aplikantët në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ofrimin e konsulencës për legjislacionin dhe procedurat që duhet të ndjekin qytetarët në zgjidhjen e problemeve të tyre, gjithashtu të sqarojë pretenduesit për ligjin, të drejtat dhe detyrimet që duhet të plotësojnë për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike;

Detyrat e Punonjësit Social në Terren :

- ✓ Kordinon punën e Bashkisë me Njësitë Administrative;
- ✓ Identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë
- ✓ Të realizoj vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë
- ✓ Eshte pjesë e kontrollit për vizitat në familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike
- ✓ Pranon dokumentacionin dhe shpërndan informacionet e firmosura me Njësitë Administrative brenda muajit;
- ✓ Siguron që të bëhet brenda afatit ligjor mbledhja e dokumentacionit që mbulohen nga kjo Drejtori;
- ✓ Merr dhe shpërndan informacion nga Njësitë administrative;

Sipas Rregullores, ***Specialisti për mbrojtjen e fëmijëve dhe barazinë gjinore*** ka këto detyra:

Për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë[3]:

- ✓ *Të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;*
- ✓ *Të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;*

[3]*Këto detyra janë të njëjta si për PMF në drejtori ashtu dhe në njësitë administrative ku ka PMF*

- ✓ *Të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;*
- ✓ *Të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;*
- ✓ *Të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;*
- ✓ *Të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes.*
- ✓ *Të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;*
- ✓ *T'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.*
- ✓ *Të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.*

Për barazinë gjinore

- ✓ *Evidentimin e rasteve të grave të dhunuara.*
- ✓ *Ofrimin e suportit psikosocial grave të dhunuara.*
- ✓ *Ofrimi i konsulencës psiko sociale për gratë e dhunuara.*
- ✓ *Ndërmjetëson për rehabilitimin e tyre si në qendra ditore, rezidenciale.*
- ✓ *Plotëson database-n elektronik.*
- ✓ *Organizon aktivitete ndërmjetësimi me tema te ndryshme.*

Tabela Nr.1 : Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror personat me aftësi të kufizuar

Nr.	Vendi	Nr. të paaftë mendor dhe fizik	Nr.të verbër	Nr.Paratetraplegjik	Nr.Invalid pune	Totali
1	Bashkia	596	194	94	1135	2019
2	Hysgjokaj	53	6	7	35	101
3	Golem	103	26	19	106	254
4	Fiershegan	131	38	15	96	280
5	Karbunarë	78	24	5	65	172
6	Allkaj	88	25	20	55	188
7	Krutje	139	29	18	118	304
8	Bubullime	95	25	19	100	239
9	Kolonjë	106	40	25	133	304
10	Ballagat	37	17	8	40	102
11	Dushk	133	28	23	137	321
	Totali	1559	452	253	2020	

Tabela Nr.2 : Të dhënat mbi fëmijët në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

Nr.	**TREGUESIT**	**2021**
1	Numri total i fëmijëve të lënë pa kujdes prindëror (gjatë vitit)	0
2	Numri total i ***fëmijëve në kujdes rezidencial*** (në fund të vitit)	*3*
3	Numri i ***fëmijëve me aftësi të kufizuara në kujdes rezidencial*** (në fund të vitit)	*1*
4	Numri dhe % e fëmijëve deri në 18 vjeç të identifikuar me ***probleme nga përdorimi i drogës;***	0
5	Numri i fëmijëve deri në 18 vjeç që trajtohen për ***problemet e alkoolit;***	0
6	Numri i rasteve të fëmijëve të: - Arrestuar; - ndaluar; - Dënuar;	0
7	Numri i rasteve të identifikuara për ***fëmijë të shfrytëzuar për lypje, punë, neglizhim nga prindi/kujdestari***	0
8	Zona/zonat ku janë identifikuar rastet e shfrytëzimit të fëmijëve për lypje	NUK KA
9	Numri i rasteve të fëmijëve viktima të dhunës në familje të pajisur me urdhër të mënjëhershëm mbrojtje/urdhër mbrojtje.	47
10	Numri i ***fëmijëve*** në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, për secilën njësi administrative[4].	**676 fëmijë**

[4]*shih tabelën 4: familje në ndihmë ekonomike;*

11	Numri i ***fëmijëve të vendosur në familje kujdestare***: - me Vendim Gjykate - pa Vendim Gjykate	 **12 fëmijë** me Vendim Gjykate

Tabela 3. Përmbledhtazi individë dhe grupe në nevojë

Nr.	Individë/grupe në nevojë	Madhësia e grupit
1	Persona me aftësi të kufizuara	***4284*** individë (PAK, Verberi, Paratetraplegji dhe invalidë pune)
2	Përfitues të ndihmës ekonomike	54*5* familje
3	Punëkërkues të papunë	*2870* individë
4	Viktima të dhunës në familje	47 individë
5	Të pastrehë	70 familje
6	Të moshuar në nevojë për shërbime	0 individë
7	Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial	3 fëmijë
8	Fëmijë me aftësi të kufizuar në shërbim rezidencial	1 fëmijë
9	Fëmijë të shfrytëzuar për lypje	0 fëmijë
10	Fëmijë në familje përfitues të ndihmës ekonomike	***676*** fëmijë
11	Fëmijë të vendosur në shërbimin e familjes kujdestare	12 fëmijë
12	Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar	0 Fëmijë

VLERËSIMI I NEVOJAVE

Nevojat për organizimin dhe strukturat e njësisë vendore

Drejtoria e ndihmës ekonomike dhe shërbimit social përbëhet nga ***drejtori dhe 7 specialist***. Duke vlerësuar rolet dhe përgjegjësitë e drejtorisë, ashtu dhe të specialistëve konstatojmë se:

Drejtoria ka marrë edhe role dhe funksione që më së shumti janë role të Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve për Njësinë Administrative Lushnje. Drejtoria duhej të

kishte rol koordinues, monitorues, mbështetës për nivelin e njësive adminsitrative dhe mbi të gjitha rol planifikues për shërbimet e kujdesit shoqëror, monitorues për shërbimet etj.

Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror

Për të vlerësuar nevojat për shërbime do ti referohemi individëve dhe grupeve në nevojë të identifikuara si dhe shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë të identifikuara. Në vijim tabela pasqyron individët/grupet në nevojë, madhësinë e grupeve, nevojat për shërbime, si dhe egzistencën e shërbimeve aktualisht. Mbi këtë bazë do të orientohet planifikimi i shërbimeve që duhet të ngrihen në vijim dhe do të jenë pjesë e Planit Social të Bashkisë Lushnje

Nr.	Individë/grupe në nevojë për shërbime	Madhësia e grupit	Shërbimi i nevojshëm për të adresuar nevojat sipas shportës së shërbimeve	Egzistenca e shërbimit
1	***Persona me aftësi të kufizuara***	*a.* ***1599*** *persona me probleme të shëndetit mendor/963* ***në Njësitë Administrative*** *b.* ***253 persona*** *para dhe tetraplegjik/****159 në Njësitë Administrative*** *c. 452 persona të verbër/****258 në Njësitë Administrative***	a. ✓ shërbim shëndetësor ✓ terapi zhvillimi ✓ terapi okupacionale b. ✓ shërbim shëndetësor ✓ fizioterapi ✓ shërbim në shtëpi c. ✓ shërbime reabilitimi ✓ shërbim në shtëpi	- Shërbim shëndetësor - 1 qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara
2	***Viktima të dhunës në familje***[5]	***47****individë*	✓ shërbimi i emergjencës 72 orëshe ✓ shërbim shëndetësor ✓ konsulencë ligjore ✓ shërbim psikologjik ✓ program punësimi	✓ jo
3	***Familje të pastreha***	*70 familje*	✓ bonus qeraja ✓ strehimi social	✓ jo
4	***Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial***	*4*	✓ shërbim i kujdesit në familje kujdestare	✓ jo
5	***Fëmijë të shfrytëzuar për lypje***	*0*		
6	***Fëmijë në familje kujdestare***	*12*	✓ monitorim	✓ jo

[5]*Shifra është indikative, pasi raportohet që në realitet ka shumë më tepër raste dhune por që nuk raportohen tek institucionet*

7	***Fëmijë me aftësi të kufizuara***	*613*	✓ shërbime reabilitimi dhe zhvillimi qendër ditore/shërbim në familje	✓ vetëm 1 qendër ditore
8	***Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar***	*0*	✓ programe riintegrimi	✓ jo

12. Strategjia e zbatimit të planit social

Koordinimi

Një grup pune do të ngrihet nga Bashkia për të bashkërenduar zbatimin e masave dhe për të raportuar mbi planin e përfshirjes sociale, me persona përgjegjës nga çdo aspekt të adresuar në të.

Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurojë që Plani Social Vendor i Bashkise Lushnje po zbatohet sipas afateve dhe synimeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në realitet.

Përgjegjësia për monitorimin

Njësia kryesore përgjegjëse për monitorimin e Planit Social Vendor ne bashkine Lushnje do të jetë drejtoria e shërbimeve sociale. Aktorë të tjerë që do të përfshihen në monitorim, sipas aktiviteteve specifike përfshijnë drejtoritë e tjera të Bashkisë, si dhe të gjithë aktorët e listuar me cilësi monitoruese në Planin Social Vendor.

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave strategjikë dhe specifikë të këtij Plani. Ai siguron mbledhjen sistematike të të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij plani për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Monitorimi dhe vlerësimi është një pjesë kritike e menaxhimit të mirë të programit dhe llogaridhënies. Përmes monitorimit, zbatuesit dhe aktorët përgjegjës për këtë plan sigurohen që aktivitetet që kryhen janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen. Monitorimi kryhet në

intervale kohore mujore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore dhe kërkon informacion nga tre fusha kryesore:

- Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë stafin, financat, materialet dhe kohën;
- Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme të planit;
- Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përftohen përmes realizimit të aktiviteteve.

Afatet kohore të monitorimit do të vendosen nga njwsia pwrgjegjwse në varësi të kohëzgjatjes së çdo aktiviteti. Aktivitetet afatshkurtra do të monitorohen në intervalet më të ngushta kohore, ato tremujore.

Vlerësimi

Në dallim nga monitorimi, ku të dhënat mblidhen periodikisht dhe përdoren për të matur progresin, vlerësimi është një analizë e detajuar e planit që synon të rishikojë arritjet e planit përkundrejt pritjeve të planifikuara, dhe të përdorë eksperiencën e fituar për të përmirësuar hartimin e planeve në të ardhmen. Vlerësimi fokusohet në rezultate duke marrë në konsideratë inputet (burimet); rezultatet në lidhje me koston; procesin e përdorur për të arritur rezultatet; relevancën e përgjithshme; ndikimin; dhe qëndrueshmërinë. Vlerësimi identifikon efektet dhe ndikimet e performancës së planit duke u fokusuar në analizën e progresit drejt arritjes së objektivave.

Raportimi

Raportimi mbi zbatimin e Planit Social Vendor do të realizohet në bazë të raporteve të përvitshme nga njësia përgjegjëse.

13.PLANI I VEPRIMIT TË PËRFSHIRJES SOCIALE

Qëllimi i PVPS

Nëpërmjet Planit të Veprimit të Përfshirjes Sociale ngrihet një strukture vendore për matjen, vlerësimin dhe monitorimin e përfshirjes sociale në këtë bashki sipas fushave politike dhe treguesve të miratuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave vendore të përfshirjes sociale të targetuara dhe të qëndrueshme për grupet në nevojë të bashkisë Lushnje, me fokus të veçantë zonat rurale të saj.

Vizioni për përfshirjen sociale

Individë dhe grupe në nevojë, të të gjitha kategorive, të shtrirë në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje, përfshihen në shoqëri nëpërmjet marrjes me lehtësi të shërbimeve sociale të ofruara nga Bashkia dhe mbështetjes në çdo fushë të përfshirjes sociale, në lidhje me çdo formë të përjashtimit social.

13.1 Prioritete strategjike për përfshirjen sociale

Prioritetet strategjike të bashkisë Lushnje për përfshirjen sociale, si rrjedhojë e gjendjes aktuale dhe prioriteteve strategjike në nivel kombëtar të janë:

Bazuar në mungesën aktuale të matjes në nivel vendor të pjesës më të madhe treguesve kombëtarë të përfshirjes sociale, mungesë e cila ka rezultuar në të gjitha fushat politike të saj nga analiza e procesit aktual të mbledhjes së të dhënave për secilën fushë:

1. Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve të Bashkisë Lushnje puna e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me shërbimin social si dhe me zbatimin e PVPS mbi matjen dhe analizën e treguesve të secilës prej fushave politike të përfshirjes sociale.

Bazuar në mungesën e eksperiencës së Bashkisë Lushnje në monitorimin dhe vlerësimin e përfshirjes sociale por dhe të shërbimit social të ofruar aktualisht, mungesë e cila ka rezultuar në të gjitha fushat politike të saj nga analiza e procesit aktual të monitormit dhe vlerësimit për secilën fushë:

2. Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve të Bashkisë Lushnje puna e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me shërbimin social si dhe me zbatimin e PVPS mbi monitorimin dhe vlerësimin në secilën prej fushave politike të përfshirjes sociale.

Bazuar në shtrirjen aktuale ndjeshëm të kufizuar të shërbimit të përkujdesit social të ofruar nga Bashkia Lushnje, e cila rezulton nga analiza e organizimit të shërbimit të mbrojtjes sociale:

3. Rritja e aksesit në shërbime sociale, veçanërisht në shërbime të përkujdesit social, për grupet në nevojë të zonave rurale të bashkisë Lushnje.

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale të përfshirjes sociale në lidhje me nevojat bazë në Bashkinë Lushnje, e cila evidenton familjet me të ardhura të ulëta si një grup veçanërisht të rrezikuar nga mungesa e strehimit për arsye të programeve aktuale financiarisht jo të arritshme për këtë grup:

4. Rritja e numrit të përfituesve të programeve sociale të strehimit nga grupet në nevojë më të pafavorizuara, veçanërisht familjet me të ardhura më të ulëta.

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale të përfshirjes sociale në lidhje me arsimin dhe shëndetësinë në Bashkinë Lushnje, në lidhje me personat me aftësi të kufizuar:

5. Zgjerimi i infrastrukturës së lëvizjes së personave me aftësi të kufizuar, në rrugë dhe institucione arsimore e shëndetësore.

Me qëllim hedhjen e hapave të parë në drejtim të përmbushjes së vizionit të Bashkisë Lushnje për përfshirjen sociale, dhe në bazë të mungesës së një studimi të mëparëshëm mbi forma specifike të mundshme të përjashtimit social në këtë bashki:

6. Identifikimi i formave të përjashtimit social të pranishme në bashkinë Lushnje dhe të qasjes ndaj tyre.

13.2 Objektivat afatmesme dhe veprimet për përfshirjen sociale

Objektiva afatmesëm

1. Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për mbledhjen, vlerësimin dhe monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë[11] të fushës së varfërisë ekonomike dhe mbrojtjes sociale;

2. Ngritja dhe konsolidimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të qendrave ekzistuese të përkujdesit social;

3. Vlerësimi i nevojave për përkujdesje sociale në të gjithë territorin e bashkisë, me fokus të veçantë në zonat rurale dhe në identifikimin e formave të reja të përjashtimit social në bashkinë Lushnje.

4. Shtrirja e shërbimeve të përkujdesjes sociale në zonat rurale të bashkisë, sipas vlerësimit të nevojave për përkujdesje sociale.

Veprime

1.1. Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS.

2.1. Krijimi brenda Bashkisë i një strukture monitorimi dhe vlerësimi të punës së qendrave ekzistuese të përkujdesit social, me 2 nëpunës shtesë.(Per orarin me 2 turne te qendres së Zhvillimit, Lushnje)

3.1 Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS.

4.1 Hartimi i planit afatgjatë të investimeve kapitale për plotësimin e shërbimit të përkujdesjes sociale në bazë të vlerësimit të nevojave.

4.2 Ngritja në njësi administrative të bashkisë të një qendre ditore të përkujdesit social për një nga kategoritë e grupeve në nevojë të cilat do të evidentohen nga vlerësimi i nevojave për përkujdesje sociale.

Objektiva afatmesëm

1. Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për mbledhjen, vlerësimin dhe monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës së nevojave bazë.

2. Përfshirja në programe sociale të strehimit të grupeve aktualisht më të pafavorizuara.

3. Zgjerimi i përfshirjes së grave viktima të dhunës në familje në programe sociale të strehimit të Bashkisë Lushnje.

Veprime

1.1 Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS

2.1 Hartimi i kritereve vendore të përzgjedhjes për programin për bonus strehimi të individëve dhe grupeve me të ardhura të pamjaftueshme për të qenë përfitues në programet sociale ekzistuese të strehimit.

2.2 Zgjerimi i programit për bonus strehimi për individë dhe grupe me të ardhura të pamjaftueshme për asnjërin prej programeve sociale ekzistuese të strehimit duke përdorur fonde shtesë të buxhetit qëndror ose vendor.

13.3 Objektiva afatmesëm arsimit dhe formimit profesional

1. Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës politike të arsimit dhe formimit profesional.
2. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për personat me aftësi të kufizuar në shkolla të përzgjedhura 9-vjeçare dhe të mesme të bashkisë Lushnje.
3. Nxitja e të rinjve të papunë për të marrë formim profesional.

Veprime

1.1 Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS.
2.1 Përzgjedhja nga ZA e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme ku do të ndërtohet infrastruktura e nevojshme për PAK sipas kritereve ligjore përkatëse.
2.2 Hartimi i një plani afatmesëm për ndërtimin e infrastrukturës PAK në shkollat e reja që ndërtohen dhe përmirësimin e saj në shkollat e përzgjedhura. Konsulencë e jashtme mund të jetë e nevojshme.
2.3 Ndërtimi dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës PAK në shkolla sipas planit afatmesëm, duke aplikuar për fonde pranë FSHZH/FZHR.
3.1 Nxitje e ngritjes së një biznesi për (10) të rinj që përfundojnë arsimin profesional nëpërmjet sigurimit të pajisjeve të punës / qirasë së mjedisit të punës për një periudhë 1 vjeçare.
3.2 Bursë për (100) të rinj nga familje të grupeve në nevojë për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional ose të përgjithshëm.

[11] *Sipas Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020, Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

14.STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT TË PVPS

Strategjia e mëposhtme do të përpiqet të përfshijë vizionin e Bashkisë në aspektin e komunikimit të çështjeve të përfshirjes sociale me rekomandimet e Dokumentit Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020 dhe kornizat e reja të informimit publik të vendosur nga ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe, në përgjithësi, me dispozitat e ligjit 139 2015" Për vetëqeverisjen lokale". Një thellim i kësaj strategjie do të pasqyrohet në "Planin e Komunikimit për përfshirjen sociale", dokument që do ti bashkëngjitet këtij Plan Veprimi.

Çfarë është pjesëmarrja e qytetarëve?

Pjesëmarrja e qytetarëve është një proces ibazuar në komunitet, ku qytetarët organizohen dhe punojnë së bashku me organizatat e komunitetit jo-qeveritare për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes. Qytetarët janë më të përfshirë në këtë proces, kur çështja është drejtpërdrejt e lidhur me to. Gjithashtu, pjesëmarrja e qytetarëve ndodh kur të gjithë pjesëmarrësit bashkëpunojnë për të realizuar ndryshimet. Pjesëmarrja publike është e bazuar në besimin se komunikimi dykahësh ndërmjet administratës dhe komunitetet lokale ofron mundësi për një dialog konstruktiv, si dhe në besimin se ata të cilët janë të prekur nga një vendim kanë të drejtë të jenë të përfshirë në procesin e vendim-marrjes Në vitin 2014, Parlamenti shqiptar miratoi Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili thekson shumë qartë shtyllat e komunikimit publik në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, duke cituar nenin 3 të ligjit në fjalë, *"Gjithkush ka të drejtë të ketë aksesoj informacionin publik, pa pasur nevojë për të shpjeguar arsyet se pse"*

Në veçanti, plani i komunikimit institucional i Bashkisë Lushnje ka për detyrë të:
Të shpjegojë dhe inkurajojë ndërgjegjësimin mbi detyrimet rregullatorë
Të promovojë aksesin ne shërbimet publike, duke promovuar njohuritë për to
Të zgjerojë njohuritë e njerëzve për shërbimet dhe përmes kësaj të ndihmojë në përmirësimin e nivelit të kënaqësisë me këto shërbime.
Përmes aktivizimit publik, të dëgjoje nevojat dhe këndvështrimet e komunitetit në mënyre që të vendosen prioritetet e duhura dhe te zhvillohet një shërbim përgjegjës.
Të arrijë grupet minoritare dhe ato me pamundësi fizike dhe financiare
Strategjia e komunikimit është zhvilluar për të ndihmuar Bashkinë Lushnje të arrijë vizionin dhe objektivat e saj dhë të përmirësojë shërbimin që ofron. Bashkia do të sigurohet qe komunikon në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse komunikimi i

Bashkisë është efektiv, ai ndikon direkt në jetën e njerëzve që marrin shërbime dhe atyre që i ofrojnë këto shërbime – duke përmirësuar kështu shërbimet dhe cilësinë e jetës të njerëzve ne zonën Bashkiake Lushnje.

Kjo strategji komunikimi konfirmon praktikën ekzistuese dhe identifikon parimet e komunikimit për të gjitha komunikimet publike.

Dhënia e Aksesit: Të gjithë qytetarët duhet të kenë akses të barabartë tek shërbimet të cilat u takojnë. Bashkia duhet të vërë në zbatim programe të posaçme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve për personat me disavantazhe fizike, sociale dhe kulturore.

Mirësjellja: Publiku duhet të trajtohet me mirësjellje dhe konsideratë. Bashkia duhet të vendosë standarte për trajtimin e publikut dhe t'i bëjë këto pjesë të Kodit të Sjelljes, vlerave dhe programeve të trajnimit.

Informacioni: Publikut duhet t'i jepet informacion i plote dhe i sakte përshërbimet bashkiake prej të cilave ai përfiton me ligj.

Sineriteti dhe Transparenca: Publiku do të informohet për mënyrën se si menaxhohet Bashkia, për buxhetin dhe për lidershipin**.**

Korrigjimet: Nëse standarti i premtuar i shërbimit nuk ofrohet, publikut duhet t'i ofrohet nje ndjese publike, një shpjegim i plotë dhe një zgjidhje e shpejtë dhe efektive. Bashkia duhet të vërë në zbatim mekanizma për të regjistruar pakënaqësitë e publikut dhe stafi duhet të trajnohet të trajtojë ankesat publike në mënyrë të shpejtë dhe efektive.

14.1 Komunikimi institucional gjithëpërfshirës në Bashkinë Lushnje

Bashkia Lushnje ka një strukturë të kompletuar, dhe çdo funksion është i mbuluar (Kjo bën që në përgjithësi marrja e informacionit në terren të jetë e mirë, përtej disa vështirësive objektive në territorin e përfshirë pas reformës territoriale, që do të përmenden në vijim. Gjithsesi, vështirësitë më të mëdha ekzistojnë në fazën e shpërndarjes së informacionit, në pjesën e komunikimit të brendshëm ashtu si dhe në atë të jashtëm. Që sistemi të funksionojë, është e nevojshme që komunikimi të konsiderohet si "trashëgimi e përbashkët", nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Komunikimi i brendshëm

Komunikim institucional nuk gjykohet vetëm ofrimi i shërbimit drejt publikut, por edhe ai i brendshëm që realizohet çdo ditë në secilën drejtori, zyrë publike dhe institucion në varësi.

Bashkia e Lushnjes kryen mbledhje periodike për marrjen, dhe menaxhimin e informacionit që vjen nga palët e interesuara dhe shpërndahet brenda administratës sipas hierarkisë dhe dispozitave të rregullores së brendshme.

Elementët rekomandues për zhvillimin e komunikimit të brendshëm të Bashkisë Lushnje , në veçanti për sa i përket fushës së përfshirjes sociale mund të përmblidhen në:

Përforcim i shpërndarjes të informacionit dhe statistikave nga ana e Drejtorisë të Politikave të Zhvillimit, në veçanti të Sektorit të Analizave, Statistikave e Planifikimit


Ky sektor, çdo vit punon në përditësimin e Buletinit statistikor, një dokument tejet i rëndësishëm të dhënash për publikun e gjerë dhe për palët e interesuara brenda dhe jashtë administratës vendore. Megjithatë, për efekt përpunimi të materialit, redaktimit dhe botimit të tij, këto të dhëna mund të mos jenë në dispozicion të administratës për një kohë të gjatë. Për këtë arsye këshillohet që të dhënat të mblidhen në disa tematika të përcaktuara (cluster) dhe të shpërndahen në administratë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose akoma më mirë përmes filtrit të zyrës së shtypit, që mund ti kanalizojë në mënyrë më të thjeshtë përmes disa instrumenteve specifike të komunikimit të brendshëm institucional, pa kosto financiare domethënëse në rastin e një neësletter të brendshme, e shpërndarë në emailet e funksionarëve të administratës. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm për të ndërtuar atë "trashëgimi të përbashkët" informacionesh që do të mundësonin një komunikim të brendshëm më të qartë të punonjësve të administratës mes tyre, si dhe ndaj publikut.

Krijimi i një Ekipi të Menaxhimit të Informacionit në fushën e përfshirjes sociale

Një plan komunikimi i mirëmenaxhuar fuqizon besimin e publikut tek qeveria lokale dhe rezulton në nivel të lartë kënaqësie për banorët dhe bizneset, por edhe në entuziazëm më të lartë të punonjësve. Nga ana tjetër, kur çështjet nuk trajtohen si duhet, Bashkia përballet me rrezikun e hapjes së çështjeve gjyqësore, humbjen e reputacionit dhe besimit nga qytetarët.

Për tu siguruar që po trajtohen çështjet e duhura dhe janë vendosur prioritete për një menaxhim efektiv, sugjerohet **krijimi i një Ekipi të Menaxhimit të Problematikave (EMP)** brenda administratës së Bashkisë, i përbërë nga stafi që punon në linjë të parë me komunitetin (Qendra e Informimit, shefat e sektorit, zyra e shtypit etj.) me qëllim kryesor analizimin e impaktit

dhe urgjencës së çështjeve sociale të mundshme për të vendosur një set prioritetesh dhe për të menaxhuar rrjedhë e komunikimit
për të gjitha çështjet e përfshirjes sociale në Bashki.



Fluksi i komunikimit i propozuar në Bashkinë Lushnje

Një EMP duhet të ngrihet për secilën prej fushave të politikave të përcaktuar nga Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2019-2021. EMP analizon problematikën dhe projekton ciklin e jetës të saj nga perspektiva e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, parashikon fushat me interes publik dhe mediatik, dhe gjykon rrezikshmërinë ndaj ekspozimit si dhe potencialet.
Kjo mund të ndikojë në mënyrë pozitive edhe në funksionimin e Zyrës së Informacionit, e përmirësuar në mënyrë progresive për të transformuar rrjedhën e komunikimit të kësaj zyre nga rrjedha me vetëm një drejtim (qytetari kërkon informacion ose denoncon një problem tek administrata) në një rrjedhë me dy drejtime (qytetaret kërkojnë informacion në lidhje me një problem, denoncojnë një problem specifik, administrata e regjistron informacionin që ta menaxhojë në bashkëpunim me departamentet e tjera. Nga kjo perspektivë, Zyra e Informacionit është pjesë integrale e EMP dhe pikënisja e procesit të menaxhimit të problematikave si një zyrë me një ndalesë, siç e parashikon dhe ligji ne nenin 74 te ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikës së Shqipërisë”.

Komunikimi i jashtëm

Komunikimi i jashtëm që i adresohet qytetarëve ndihmon për të ndërtuar perceptimin e cilësisë së shërbimeve si një kanal i përhershëm dëgjesash dhe kontrollesh mbi nivelin e kënaqësisë së përdoruesit, në mënyrë qe t’i mundësojë Bashkisë të përshtasë shërbimet që ofron me kalimin e kohës. Në vijim paraqiten disa sugjerime për instrumentet kryesorë të komunikimit me publikun të Bashkisë Lushnje , sidomos në fushën e përfshirjes sociale.

Faqja web

Faqja zyrtare web e Bashkisë Lushnje (*wwwbashkialushnje.gov.al*) është mjeti i pare dhe më i rëndësishëm i Bashkisë Lushnje , dhe më i përditësuari me aktivitetet institucionale, përfshi këtu edhe ato që kanë lidhje me gjithëpërfshirjen sociale.

Përtej nevojës që të gjitha kategoritë e listuara në faqen ëeb të përditësohen periodikisht me përmbajtje të freskët, edhe gjatë periudhës së verës, në faqen kryesore të internetit të Bashkisë duhet të ketë një organizim sa më racional në drejtim të aksesit të informacionit.
Në mënyrë të veçantë, për aq kohë sa ky Plan Komunikimi merret me strategjitë e përfshirjes sociale, është shumë e rëndësishme zhvillimi i një sektori të caktuar brenda ëebsitit, të konceptuar dhe të përshtatur për problematikat e Çështjeve Sociale.
Në këtë kuadër mund të mendohet edhe një faqe interneti e pavarur, që lidhet falë një linku me faqen zyrtare të Bashkisë, ose gjithsesi një sektor autonom i çështjeve sociale në kuadër të faqes zyrtare.
Në brendësi, faqja e shërbimeve sociale duhet të ndahet në kategori të ndryshme, mundësisht në përputhje me fushat e politikave të përshkruara nga dokumenti politik për përfshirjen sociale 2016-2020, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr 87, më 3 shkurt të vitit 2016. Në veçanti, sugjerohet një ndarje në fushat e mëposhtme: Nevoja bazë, Varfëria dhe Mbrojtja Sociale, Pjesëmarrja dhe të Drejtat e Njeriut, Punësimi dhe Aftësitë, Edukimi dhe Trajnimet.

Secila nga këto fusha duhet të ketë në brendësi disa nënkapituj. Në të, përdoruesit duhet të gjejnë legjislacionin kombëtar dhe vendor lidhur me problematikën, shërbimet e ofruara nga Bashkia (Qendrat ditore, institucionet e rehabilitimit, manualeve dhe botimeve të njohura dhe të rëndësishme, një seksion FAQ i hartuar në bashkëpunim me palët e interesuara (spitalet, institucionet, OJQ-të, dhe më e rëndësishmja, vetë njerëzit me aftësi të kufizuara). Një sektor duhet të pasqyrojë projektet dhe iniciativat që Bashkia ka implementuar ose ka si qëllim të zbatojë në fushën sociale specifike

Duke marrë në konsideratë, përshembull, diferencat sensoriale dhe auditive të PAK, nën-kapitullit që i përket kësaj kategorie mund ti shtohen disa instrumenta “miqësorë” që do të thjeshtëzonin aksesin e informacionit, si përmbledhje zanore të përditësuar e lajmeve dhe aktiviteteve kryesore të Bashkisë, si dhe të shërbimeve që Bashkia ofron kësaj kategorie.
Në fusha të ngjashme, faqet specifike të internetit mund të jenë të dizajnuara për kategori të ndryshme: mosha e tretë, çështjet gjinore, mbrojtja e të miturve dhe të Drejtat e Njeriut. Për kategorinë e fundit, në mënyrë të veçantë, një sugjerim i fortë është ai që të merret në

konsideratë dhe të rezervohet një hapësirë e veçantë për minoritetet etnike si komuniteti rom, egjiptian etj. Kjo hapësirë duhet të mbushet jo vetëm me legjislacionin, formularë të dobishëm, etj, por edhe me një përmbledhje të thjeshtë, por gjithsesi të plotë të traditave të tyre dhe organizatave përfaqësuese, si dhe një agjendë e përditësuar të aktiviteteve të tyre sociale, fetare dhe kulturore, që mund të gjenerojnë një interes relevant në opinionin publik, duke ndihmuar kështu në procesin e përfshirjes sociale. Përveç kësaj, për shkak të reformës së re territoriale, çdo sektor social duhet të përfshijë njësitë e reja administrative të përfshira në territorin e Bashkisë. Banorët e këtyre territoreve, shpesh relativisht të largët nga qendër të qytetit, duhet të ndjejnë afërsinë e administratën të Bashkisë të Lushnjes në problemet dhe kërkesat e tyre të përditshme. Pra në faqen ëeb duhet të pasqyrohen lidhjet e transportit publik, zyrat ose institucionet më të afërta, si dhe një paketë të plotë të formateve-tip për të shmangur udhëtimet e gjata në zyrat qendrore (që në disa raste, mund të zgjasin edhe disa orë).

Revista elektronike

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", përcakton botimin,të paktën një herë në dy muaj, të një revistë elektronike zyrtare të Bashkisë, e cila duhet të shfaqet në faqen zyrtare të bashkisë në mënyrë që të shpërndahet në mënyrë elektronike në çdo banor të interesuar. Revista elektronike duhet të përmbajë, përveç akteve të miratuara nga bashkia gjatë periudhës referuese, një pasqyrë të plotë të aktiviteteve të njësive organizative, prezantimin e planit të punës për muajt e ardhshëm, vendet e lira të punës në bashki dhe prokurimet e planifikuara për periudhë vijuese.

Rrjetet sociale

Rrjetet sociale kanë fituar një ndikim të jashtëzakonshëm në komunikim nga pjesë e madhe e opinionit publik, sidomos nga të rinjtë. Bashkia e Lushnjes, si çdo institucion tjetër publik, duhet të jetë aktivisht e pranishme në ato media që, për shkak të përdorimit gjithmonë e më të madh të smartfonëve nga popullsia shqiptare, mund të jenë një burim i menjëhershëm dhe shumë i dobishëm të informacionit për komunitetin. Përdorimi i mediave sociale për qëllime institucionale mund të jetë shumë i dobishëm dhe nganjëherë e vetmja mundësi komunikimi në raste të veçanta, të tilla si anulimi i papritur i ngjarjeve të planifikuara, por edhe për qëllime të jashtëzakonshme (në rastin e fatkeqësive natyrore, njerëzve të humbur në zona të largëta etj).

Bashkia e Lushnjes është e pranishme në media sociale, nëpërmjet llogarisë Facebook, linku i të cilës është i pranishëm edhe në faqen zyrtare. Prania efektive dhe e përditësuar e Bashkisë Lushnje në këtë rrjete sociale do të bëj që administrata t'iu përgjigjet në kohën e duhur shqetësimeve të qytetarëve, duke përmirësuar reputacionin e gjithë institucionit.

Botimet

Edhe pse botimi i një organi të përjavshëm ka një kosto financiare relevante,është serish i mundur ideimi i një suplementi periodik (dy ose katër faqe) që mund ti bashkohej gazetave lokale ose kombëtare, që përmban aktivitetet kryesore të Bashkisë, një kalendar i takimeve dhe eventeve etj. Ky do të ishte një instrument shumë i pëlqyer dhe i vlefshëm për kategori të caktuara që nuk kanë familiaritet me internetin dhe rrjetet sociale, në veçanti për më të moshuarit.

Numri i broshurave dhe fletëpalosjeve informuese, sidomos në fushat e përfshirjes sociale duhet të rriten në mënyre thelbësore. Bashkia duhet të krijojë një hapësirë në buxhet për printimin e këtyre materialeve, që janë tepër të vlefshëm për përhapjen e informacionit, në mënyrë që ato mos të jenë rezultat i disa projekteve dhe donatorëve, por pjesë përbërëse e strategjisë të komunikimit të Bashkisë. Në këtë prizëm, është e rëndësishme që këto materiale të përditësuara të jenë të pranishme në zyrat më të aksesueshme nga kategoritë e rrezikuara nga mundësia e përjashtimit social, si Drejtoria e Shërbimeve sociale, Zyra e Informacionit, Qendra Multifunksionale, qendrat e njësive administrative, krahas me materialet shpjeguese të aktiviteteve të tyre specifike, duhet të jenë të pajisura edhe me broshura dhe fletëpalosje të ndara në kategoritë përbërëse të përfshirjes sociale.

Këndet e informimit në njësitë administrative

Një nga sfidat më të mëdha të Bashkisë Lushnje në vitet e fundit ka qenë përfshirja në korpusin e komunitetit të saj tradicional të komuniteteve dhe territoreve të ish komunave dhe bashkive që iu bashkëngjitën sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 115/2014 dt. 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Për këtë arsye, duket më se i nevojshëm një rikonceptim i sistemit të shpërndarjes së informacionit në këto njësi administrative, dhe në veçanti ngritja e disa këndeve informimi, të pajisura me materiale ilustruese të printuara si dhe mjetet teknologjike (PC, printer, skaner,

dhe natyrisht lidhje në internet) të nevojshme dhe të mjaftueshme për marrjen në vend të formularëve ose dokumentacionin e kërkuar, ose ne përgjithësi të informacionit të duhur. Prania e këtyre këndeve do të ishte një shtysë për komunitetin e atyre zonave, përgjithësisht me karakter rural, që për arsyet e parashtruara të kohës dhe distancës, nuk kanë mundësi ose ngurrojnë të shkojnë në Lushnje. Gratë, të moshuarit dhe të miturit do të kishin një mundësi më shumë për tu informuar mbi të drejtat e tyre, dhe për të marrë një pjesë të shërbimit të nevojshëm.

KORNIZA E PLANIT LOKAL TE VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE 2019 2022
Bashkia Lushnje

Qëllimi 1 – Ngritja/zhvillimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve

Aktivitetet	**Aktorët përgjegjës**	**Afatet**	**Treguesit**	**Baza e informacionit**	**Financimi**	**Monitorimi**
Objektivi 1 – Ngritja e Njësive të Mbrojtjes së fëmijëve në bashki/NJA						
Ndërtimi i strukturës së NJMF-së në bashki/NJA *(me të paktën 2 persona në stafin e Bashkisë Qendrore dhe 1 PMF në çdo NJA që ka mbi 3000 fëmijë)*	*Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki*	*2023*	*Numri i strukturave të ngritura në raport me numrin e fëmijëve në zonë (sipas ligjit) dhe në raport me numrin e strukturave të mëparshme*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"*	*Bashkia*	*MSHMS, SHSSH, Drejtoria Rajonale e SHS*
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës të PMF-së në bashki/NJA *(sipas modelit të propozuar nga ASHMDF)*	*NMF-ja qendrore ne baski + drejtori i drejtorise se Sherbimit Social*	*2024*	*Përshkrimi i punës i miratuar për PMF në bashki dhe NJA*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	*Bashkia*	*Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki*
Objektivi 2 – Forcimi i koordinimit/qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në bashki/NJA						
Ngritja e grupit teknik ndërsektorial (GTN) të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në bashki/NJA	NMF-ja qendrore ne bashki + drejtori i drejtorise se Sherbimit Social	*2023*	*Dokumenti i miratimit të GTN* *Numri i takimeve të GTN në raport me numrin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që ndiqen nga GTN dhe numrin e takimeve të GTN për çdo rast sipas ligjit*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	*MSHMS, SHSSH, Drejtoria Rajonale e SHS*

Integrimi i NJMF-ve brenda Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR)	Drejtoria e Sherbimit Social	*2022*	*Përfshirja e roleve dhe përgjegjësive reciproke në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në përshkrimet e punës të të gjithë punonjësve të NJVNR*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Bashkia
Krijimi dhe përditësimi i hartës lokale dhe adresarit të shërbimeve/projekteve vendore për fëmijë dhe familje	Pergjegjese IT, bashki	2025	*Dokumenti i hartës lokale dhe i adresarit, të përditësuar çdo vit*		Bashkia, Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Objektivi 3 – Ngritja e strukturës së supervizimit në bashki						
Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i supervizimit në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	Drejtori i Sherbimit Social	2023	*Dokumenti i planifikimit të supervizimit Marrëveshja vjetore e supervizimit për çdo punonjës të mbrojtjes së fëmijëve*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Zbatimi i procedurave të supervizimit dhe roleve e përgjegjësive të supervizuesit e të supervizuarit *(sipas udhëzimeve të ASHMDF)*	ASHMDF	2022	*Numri i takimeve të supervizimit të realizuara në raport me numrin e takimeve të planifikuara në marrëveshjen vjetore*		Bashkia nw bashkwpunim me OJF kombetare	Bashkia

Qëllimi 2 – Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja për mbrojtjen e fëmijëve

Aktivitetet	**Aktorët përgjegjës**	**Afatet**	**Treguesit**	**Baza e informacionit**	**Financimi**	**Monitorimi**
Objektivi 1 - Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje						
Prezantimi dhe vënia në dispozicion të të gjithë	Te gjitha institucion	2022	*Numri i formave të shpërndara në raport me*	*Ligji "Për të drejtat dhe*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF

profesionistëve/institucioneve përgjegjëse i të gjitha formave të dokumentimit për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe me detyrimet ligjore përkatëse	et pale e marrveshjes per bashkepunim		*numrin e formave ekzistuese të dokumentimit sipas ligjit* *Numri i formave të shpërndara në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse (elektronikisht ose në formë të printuar)* *Çdo dosje e PMF për një fëmije në situatë për mbrojtje përmban të gjitha format e mësipërme të plotësuara*	*mbrojtjen e fëmijëve*		
Ngritja e skuadrave të lëvizshme, te terrenit, në bashkëpunim me partnerët dhe skuadrat e shërbimeve për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kërkojnë identifikim proaktiv *(fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomisht, fëmijët në rrezik për trafikim/viktima të trafikimit, etj)*	Drejtoria e Sherbimit Social, Bashki	2022	*Numri i skuadrave të ngritura në raport me numrin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kërkojnë identifikim proaktiv përgjatë vitit të mëparshëm*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për lëvizshmërinë dhe proaktivitetin e strukturave përgjegjëse për realizimin e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje *(sigurimi i mjeteve të transportit dhe komunikimit)*	Drejtoria e Finances - Bashkia	Cdo kohe kur identifikojne femije ne nevoje	*Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë);*		Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF

		dhe rrezik	*Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën për komunikim*			
Afishimi i dukshëm i numrave të kontaktit për raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në të gjitha institucionet relevante publike dhe jopublike dhe mjediset komunitare	NJMF qendrore	2023	*Numri i afishimeve të dukshme në raport me numrin e institucioneve relevante publike dhe jopublike* *Numri i afishimeve të dukshme në raport me numrin e mjediseve komunitare në zonë*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Hartimi i marrëveshjeve të bashkisë me institucione të tjera që përfshihen në identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje	Drejtori i Sherbimit Social	2024	*Marrëveshja me institucionin përkatës*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Objektivi 2 – Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje						
Ofrimi i shërbimit 24 orësh për përgjigjen ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.	NJMF	2022	*Shërbimi 24-orësh është i ngritur dhe funksional* *Numri i rasteve të fëmijëve fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kanë marrë përgjgije menjëherë me momentin e prezantimit të nevojës në raport me numrin e rasteve të fëmijëve me nevojave emergjente*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF

Ngritja/funksionimi i vazhdueshëm i qendrës së emergjencës/pritëse për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje	Bashkia	2023	*Mjedisi i qendrës së emergjencës i ndërtuar (pajisje zyre-kompjuter, printer, mjedis miqësor për fëmijët, telefon, transport)* *Marrëveshja me ofruesin jopublik të shërbimit (nëse ka)*		Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për strukturat përgjegjëse për realizimin me efektivitet të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje *(sigurimi i hapësirave – zyrë, pajisje, si kompjuter, printer, etj-, dhe i mjeteve të transportit dhe komunikimit)*	Bashkia	Gjate gjithe kohes	*Zyra e PMF përmban pajisje zyre-kompjuter, printer, mjedis miqësor për fëmijët, telefon, transport* *Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë);* *Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën për komunikim*		Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Përmirësimi i infrastrukturës së bashkisë për të krijuar mjedise	Bashkia	Cdo kohe	*Numri i mjediseve/hapësirave të*	*Ligji "Për të drejtat dhe*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF

miqësore (veçanërisht konfidenciale) për fëmijët			*kthyera në mjedise miqësore për fëmijët në raport me numrin e mjediseve/hapësirave që kanë nevojë për këtë përmirësim* *Takimet me fëmijët realizohen me dyer të mbyllura në mjedise konfidenciale* *Në takimet me fëmijët marrin pjesë vetëm personat relevantë sipas ligjit*	*mbrojtjen e fëmijëve*		

Qëllimi 3 – Ndërgjegjësimi institucional e komunitar për mbrojtjen e fëmijëve

Aktivitetet	**Aktorët përgjegjës**	**Afatet**	**Treguesit**	**Baza e informacionit**	**Financimi**	**Monitorimi**
Objektivi 1 – Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve						
Aktivitete informuese me institucionet përkatëse (arsim, shëndetësi, polici, lidhur me shërbimet ekzistuese dhe të reja për mbrojtjen e fëmijëve dhe përgjegjësitë përkatëse	Njmf	Cdo kater muaj	*Numri i institucioneve pjesëmarrëse në raport me numrin e institucioneve publike e jopublike për mbrojtjen e fëmijëve në zonë* *Numri i punonjësve pjesëmarrës në çdo aktivitet në raport me numrin e punonjësve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në çdo institucion*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF

Aktivitete informuese me komunitetin lidhur me shërbimet ekzistuese dhe të reja për mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet përgjegjëse dhe të drejtat e fëmijëve për mbrojtje	Njmf	Cdo kater muaj	*Numri i qytetarëve pjesëmarrës në raport me numrin e prindërve/fëmijëve në zonë*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia Donatore	Bashkia, grupet e interesit, OJF
Përgatitja dhe shperndarja e broshurave informuese mbi shërbimet ekzistuese dhe të reja për mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet përgjegjëse dhe të drejtat e fëmijëve për mbrojtje	ASHMDF	Cdo vit	*Numri i materialeve informuese të shpërndara në raport me numrin e prindërve/fëmijëve në zonë*		Bashkia Donatore	ASHMDF Bashkia, grupet e interesit, OJF

Qëllimi 4 – Rritja e kapaciteteve organizative të bashkisë për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve

Aktivitetet	**Aktorët përgjegjës**	**Afatet**	**Treguesit**	**Baza e informacionit**	**Financimi**	**Monitorimi**
Objektivi 1 – Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin, monitorimin dhe raportimin e mbrojtjes së fëmijëve						
Krijimi dhe përditësimi nga çdo NJMF i bazës së të dhënave mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje	NjMF	2022	*Baza e të dhënave e ndërtuar* *Baza e të dhënave e përditësuar me situatat e fundit të rasteve të fëmijëve* *Numri i institucioneve që japin informacion mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse në zonë*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve Bashkia, OJF, grupet e interesit

Prezantimi periodik i të dhënave sasiore të procesuara dhe informacionit për situatën e mbrojtjes së fëmijëve në territorin e bashkisë tek ASHMDF	NJmf	2023	*Të dhënat sasiore prezantohen në mënyrë periodike te ASHMDF sipas ligjit*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	ASHMDF Bashkia, OJF, grupet e interesit
Analiza periodike multisektoriale e situatës së mbrojtjes së fëmijëve, bazuar mbi rastet në nevojë për mbrojtje	Drejtori i Sherbimit Social	2022	*Dokumenti i raportit vjetor të analizës periodike multisektoriale*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Bashkia, OJF, grupet e interesit
Raportim vjetor (ose dhe më shpesh nëse gjykohet e mundur) pranë Këshillit Bashkiak , përfshirë rekomandime në lidhje me përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijëve në bashki	Drejtori i Sherbimit Social	2023	*Dokumenti i raportit vjetor*		Bashkia	Bashkia, OJF, grupet e interesit
Objektivi 2 - Zhvillimi i aftësive organizative për buxhetimin e mbrojtjes së fëmijëve						
Analizë e kostos së zbatimit të planit social për mbrojtjen e fëmijëve	Drejtoria e Finances	2022	*Kostimi vjetor i planit*	*Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*	Bashkia	Bashkia
Hartimi i planbuxheteve vjetore per zbatimin e planit të mbrojtjes së fëmijëve	Drejtoria e Finances	2022	*Dokumenti i planbuxhetit bazuar në kostimin vjetor të planit*		Bashkia	Bashkia
Buxhetimi vjetor i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, bazuar në numrin e fëmijëve për nevojë për mbrojtje gjatë vitit paraardhës dhe/ose nevojat e identifikuara përgjatë tij *(sipas udhëzimeve të MMSR)*	Drejtoria e Finances	2023	*Buxhetimi i vitit pasardhës sipas udhëzimevve të MMSR*		Bashkia	Bashkia

Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/ Veprimet		2022	2023	2024	Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlerësuar	Bashkia Lushnje 2021-2023	Partnerë të zhvillimit
	VARFERIA EKONOMIKE DHE MBROJTJA SOCIALE						**37,826,440**	34,626,440	3,200,000
Objektivi 1	Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për mbledhjen,vlerësimin dhe monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës së varfërisë ekonomike dhe mbrojtjes sociale								
Veprimi 1.1	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	MSHMS	Bashkia Lushnje /OJQ		Pa kosto	
Objektivi 2	Ngritja dhe konsolidimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të qendrave të përkujdesit social								
Objektivi 3	Vlerësimi i nevojave për përkujdesje sociale në të gjithë territorin e bashkisë, me fokus të veçantë në zonat rurale dhe në identifikimin e formave të reja të përjashtimit social në bashkinë Lushnje								

Veprimi 3.1	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	MSHMS	Bashkia Lushnje /OJQ		Pa kosto	
Veprimi 3.2	Rivlerësimi i (i) *vendndodhjes* së qendrës eksiztuese të Zhvillimit(ii) *kapacitetit* të saj dhe (iii) *llojit* të shërbimit që ofron në bazë të të dhënave nga vlerësimi i nevojave për përkujdesje sociale		X	X	Bashkia Lushnje	UNICEF/ OJQ	UNICEF		UNICEF
Objektivi 4	Shtrirja e shërbimeve të përkujdesjes sociale në zonat rurale të bashkisë, sipas rivlerësimit të nevojave për përkujdesje sociale								
Veprimi 4.1	Hartimi i planit afatgjatë të investimeve kapitale për plotësimin e shërbimit të përkujdesjes sociale në bazë të rivlerësimit të nevojave		X	X	Bashkia Lushnje			Pa kosto	
Veprimi 4.2	Ngritja në njësi administrative të bashkisë të një qendre ditore të moshuarve		X	X	Bashkia Lushnje	OJQ	4,000,000	4,000,000	
Veprimi 4.3	Akreditimi i Qëndrës të Zhvillimit Lushnje		X	X	Bashkia Lushnje	Agjenci Akredituese	3,200,000		3,200,000

Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/Veprimet	Afati i zbatimit			Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlersuar	Bashkia Lushnje 2019-2021	Partner të zhvillimit
	2022	2023	2024					

							4,000,000		4,000,000
NEVOJAT BAZË									
Objektivi 1	Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për mbledhjen, vlerësimin dhe monitorimin në nivel vendor të reguesve kombëtarë të fushës së nevojave bazë								
Veprimi 1.1	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	MSHMS	Bashkia Lushnje		Pa kosto	
Objektivi 2	Përfshirja në programe sociale të strehimit të grupeve aktualisht më të pafavorizuara								
Veprimi 2.1	Hartimi i kritereve vendore të përzgjedhjes për programin për bonus strehimi të individëve dhe grupeve me të ardhura të pamjaftueshme për asnjërin prej programeve sociale ekzistuese të strehimit		X	X	Bashkia Lushnje	MFE		Pa kosto	

Veprimi 2.2	Zgjerimi i programit për bonus strehimi për individë dhe grupe me të ardhura të pamjaftueshme për asnjërin prej programeve sociale ekzistuese të strehimit duke përdorur f onde shtesë të buxhetit qëndror ose vendor		X	X	Bashkia Lushnje	MFE	4,000,000		4,000,000
Objektivi 3	Zgjerimi e përfshirjes së grave viktima të dhunës në familje në programe sociale të strehimit të Bashkisë Lushnje								

Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/Veprimet		Afati i zbatimit			Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlersuar	Bashkia Lushnje 2021-2023	Partner të zhvillimit
		2022	2023	2024			**34,938,000**	7,000,000	9,600,000
ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL									
Objektivi 1	Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës politike të arsimit dhe formimit profesional								
Veprimi 1.1	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria e Shëndetësise dhe Mirëqënies Sociale , në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	MSHMS	ZA Bashkia Lushnje	/	Pa kosto	

Objektivi 2	Investime në shkolla të përzgjedhur 9-vjeçare të bashkisë Lushnje						12,063,000	12,063,000	
Veprimi 2.1	Investime në shkolla të përzgjedhur të mesme të përgjithshme të bashkisë Lushnje		X	X	Bashkia Lushnje	ZA	22,875,000	22,875,000	
Veprimi 2.2	Hartimi i një plani afatmesëm për ndërtimin e infrastrukturës PAK në shkollat e reja që ndërtohen dhe përmirësimin e saj në shkollat e përzgjedhura; konsulencë e jashtme mund të jetë e nevojshme		X	X	Bashkia Lushnje	ZA	7,000,000		7,000,000
Veprimi 2.3	Ndërtimi dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës PAK në shkolla sipas planit afatmesëm, duke aplikuar për fonde pranë FSHZH/FZHR						9.600.000		9.600.000
Objektivi 3	Nxitja e të rinjve të papunë për të marrë formim profesional								
Veprimi 3.1	Bursë për (100) të rinj nga familje të grupeve në nevojë për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional ose të përgjithshëm		X	X	Bashkia Lushnje	Qëndra/ shkolla e arsimit professional dhe të	13.000.000	13.000.000	

						përgjiths-hëm			

Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/Veprimet		Afati i zbatimit			Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlersuar	Bashkia Lushnje 2021-2023	Partner të zhvillimit
		2022	2023	2024			15.645.434	4,693,630	10.951.840
SHËNDETËSIA									
Objektivi 1	Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës politike të shëndetësisë								
Veprimi 1.1	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	MSHMS	Bashkia Lushnje / DSH/ OJQ		Pa kosto	

Objektivi 2	Ngritja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të treguesvekombëtarë të përfshirjes sociale në fushën e shëndetësisë								
Veprimi 2.1	Zgjerimi i platformës së bashkëpunimit mes Bashkisë Lushnje dhe DSH Lushnje dukepërfshirë një raportin gjashtëmujor të DSH Lushnje ndaj Bashkisë mbi treguesit e përfshirjes sociale në fushën eshëndetësisë		X	X	Bashkia Lushnje	DSH		Pa kosto	
Objektivi 3	Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për personat me aftësitë kufizuar në qendra të përzgjedhura shëndetësore e të bashkisë Lushnje								
Veprimi 3.1	Përzgjedhja nga DSH e qendrave shëndetësore ku do të ndërtohet infrastruktura e nevojshme për PAK sipas kritereve ligjore përkatëse		X	X	Bashkia Lushnje	DSH			
Veprimi 3.1	Hartimi i një plani afatmesëm të investimeve kapitale për ndërtimin e infrastrukturës PAK në qendrat shëndetësore të përzgjedhura; konsulencë e jashtme mund të jetë e nevojshme		X	X	Bashkia Lushnje	DSH/QSH	4,693,630	4,693,630	

Veprimi 3.2	Ndërtimi dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës PAK në qendra shëndetësore sipas planit afatmesëm, duke aplikuar për fonde pranë FSHZH/FZHR		X	X	Bashkia Lushnje	DSH	7,000,000	4,000,000	3,000,000

		Afati i zbatimit			Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlersuar	Bashkia Lushnje 2021-2023	Partner të zhvillimit
		2022	2022	2024			**6,561,000**	6,561,000	0
Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/Veprimet									
PUNËSIMI DHE AFTËSITË									
Objektivi 1	Ngritja dhe konsolidimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit në fushën e punësimit dhe aftësive me fokus individët që marrin ndihmë ekonomike								
Veprimi 1.1	Ngritja e një platforme bashkëpunimi të Bashkisë Lushnje me ZP Lushnje përmes së cilës të monitorohet dhe vlerësohen mundësitë për punësim dhe për të zhvilluar aftësitë e individëve që marrin ndihmë ekonomike pranë Bashkisë		X	X	ZP			Pa kosto	
Objektivi 2	Nxitje e bizneseve private për punësimin e individëve në nevojë: PAK, antarë të familjeve që marrin ndihmë ekonomike, gra, individë të komunitetit rom ose egjiptian								
Veprimi 2.1	Nxitja e punësimit të (30) grave që marrin ndihmë ekonomike nëpërmjet pagesës për		X	X	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje	6,561,000	6,561,000	

	llogari të punëdhënësit të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor për një periudhë 6 mujore								
Fushat politike të përfshirjes sociale/Objektivat/Veprimet		Afati i zbatimit			Institucioni përgjegjës	Institucione të përfshira	Buxheti i nevojshëm i vlersuar	Bashkia Lushnje 2019-2021	Partner të zhvillimit
		2022	2023	2024			**34,626,440**	34,626,440	0
PJESËMARRJA SOCIALE DHE TË DREJTAT E NJERIUT									
Objektivi 1	Zhvillimi i kapaciteteve vendore të Bashkisë Lushnje për monitorimin në nivel vendor të treguesve kombëtarë të fushës së pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut								
Veprimi 1.2	Pjesëmarrja në trajnime për përfshirjen sociale të planifikuara nga Ministria e Shëndetësië dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të DPPS		X	X	Bashkia Lushnje	OJQ/SHC		Pa kosto	
Objektivi 2	Rrijta e aksesit të grupeve në nevojë në veprimtari social-kulturore të organizuara nga Bashkia Lushnje								
Veprimi 2.1	Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile dhe shoqata të grupeve në nevojë për shpërndarjen e informacionit mbi aktivitete social-kulturore të organizuara nga Bashkia dhe promovimin e kalendarit të këtyre aktiviteteve		X	X	Bashkia Lushnje	OJQ/SHC	450,000	450,000	
Objektivi 3	Aktivitete në ndihmë të fëmijëve të dhunuar		X	X	Bashkia Lushnje	OJQ/SHC			

Veprimi 3.1	Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile dhe shoqata të grupeve në nevojë për aktivitete argëtuese për fëmijët e dhunuar të organizuara nga Bashkia.				Bashkia Lushnje	OJQ/SHC			
Veprimi 3.2	Ngritje e strukturave në kopsht me psikolog në ndihmë të fëmijëve të dhunuar.				Bashkia Lushnje	ZA			

BIBLIOGRAFI

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 – 2025

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023

Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ligj nr. 107/2014 datë 31.7.2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Ligj nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndrysuar

Ligj Nr. 10347/2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"

Ligji Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Ligji Nr. 10221/2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

Ligji Nr. 10329/2010, "Për disa ndryshime dhe amendime në Ligjin Nr. 9669/2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

Ligji Nr. 10399/2011, "Për disa mendime dhe shtojca" në Ligjin Nr. 9355/2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"

Ligji Nr. 163/2014, "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë"

Ligji Nr. 9355/2005, "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar

Strategjia ndërsektorial për decentralizimin dhe qeverisjne vendore 2020-2022

Strategjia ndër sektoriale për reformën në administratën publike 2015 – 2022.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021- 2025, Ministria e Drejtësisë

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2021-2030

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2020 – 2021)

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2020-2023

Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2021-2026

Draft ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Unicef (2015) Supporting Planning of Social Care Services: SOCIAL CARE SERVICES PLANNING TOOLKIT